2-060/5439
21/06/2023

REPUBLIKA E KOSOVES – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02-180/06/23**
**Datë: 21.06.2023 .**

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

# FTESË

**Për:** Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Nga:** **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Lënda:** Mbledhja e gjashtë (6) - e rregullt 2023 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
**Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;**
**Data:** **30.06.2023**, ora **10** [00].

## Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizes Afatmesme Buxhetore komunale 2024-2026;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunen e Junikut;
5. Rapoti i komisionit zgjedhor rreth zgjedhjeve te keshillave lokale në Komunen e Junikut;
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 14.06.2023 |
| PËR/ZA/TO: | z. Shpejtim Gacaferi– Kryesues i Kuvendit Komunal, Junik |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës, Junik |
| NGA/OD/FROM: | znj. Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për të shtuar në rend dite shqyrtimin dhe miratimin e KAB-it komunal 2024/2026 |

I nderuar,

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive (LMFPP) nr.03/L-048, neni 20 dhe neni 61, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, neni 40 alinea 40.2, pika b), si dhe duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2024/01 për Komunat të nisur nga Ministria e Financave, kërkojmë nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal që të bëjë shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2024/2026 për Komunën e Junikut.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

(Projekt)

# KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

2024- 2026

JUNIK, 2023

# I. KORNIZA AFATMESME BUXHETORE PËR K.K – JUNIK

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) që po e paraqesim këtu është një dokument i cili miratohet çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky dokument ofron një analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës. Grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake. Shpenzimet janë planifikuar ashtu që të pasqyrojnë prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KAB siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuara në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.
Hartimi i KAB-it 2024-2026 është një kërkesë obligative dhe kërkohet përmes Qarkores Buxhetore 2024/01 për Komunat, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
Ne kemi shqyrtuar KAB-in në kuptim të planifikimit afatmesëm. Karakteristikat më kryesore të tij janë si në vijim:

- Parashikimet ekonomike dhe buxhetore;
- Strategjinë zhvillimore komunale;
- Totalet e vlerësuara të të hyrave nga të gjitha burimet e financim;
- Caqet totale për shpenzime në programe dhe nën-programe ;
- Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve

Prandaj procesin që kemi ndjekur ne është si në vijim:

- Rishikimi i politikave të të hyrave dhe identifikimi i të hyrave
- Paraqitja e prioriteteve strategjike dhe rezultateve të pritura
- Rishikimi i ndërlidhjes së buxhetit të kaluar me prioritete dhe rezultatet e arritura.
- Planifikimi i buxhetit për periudhë afatmesme për të punuar drejt arritjes së prioriteteve strategjike
- Zhvillimi i indikatorëve dhe caqeve për të matur progresin drejt prioriteteve strategjike dhe rezultateve

KAB paraqet prioritetet komunale të shpërndarjes së mjeteve për periudhën 2024-2026.

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Komunës se Junikut është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, e cila është ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2024/2026 të dhëna nga MFPT përmes qarkores buxhetore 2024/01 .
Korniza afatmesme buxhetore ( KAB ) komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB – Komunal do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioriteteve të tanishme dhe afatmesme të Junikut si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2024 – 2026, gjithnjë duke u bazuar në :

1. Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
2. Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
3. Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
4. Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

## II. OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Me kornizën afatmesme buxhetore 2024–2026 të Komunës së Junikut synohen të arrihen këto objektiva:

- Zhvilloj, promovoj dhe rigjeneroj infrastrukturën lokale;
- Përmirësoj ambientin për të jetuar;
- Përmirësoj sigurinë dhe shëndetin e komunitetit;
- Zhvilloj sferën e shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit;
- Ofroj mjete për nevojtarët dhe të dëmtuarit;
- Përkrah dhe zhvilloj biznesin dhe aftësitë individuale të talenteve etj.

## III. Perspektiva e politikave fiskale

### Korniza makroekonomike

Komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), prandaj Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

### Parashikimi i të hyrave komunale

Të hyrat komunale të Komunës sonë realizohen në bazë të Rregullores mbi Taksat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj të hyra, siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.
Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

**Tabela 1. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale**

| | Burimet e te hyrave | 2023 Buxheti | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Projeksioni | |
| 1 | **Gjithsej grantet ndërqeveritare** | **1,718,016** | **1,991,780** | **2,098,768** | **2,202,666** |
| 2 | **Gjithsej te hyrat vetanake te komunës** | **159,330** | **208,056** | **216,073** | **227,996** |
| 2.1 | Te hyrat nga shërbimet kadastrave | 13,111 | 16,001 | 16,028 | 16,157 |
| 2.2 | Te hyrat nga urbanizmi | 8,200 | 16,000 | 17,000 | 18,500 |
| 2.3 | Te hyrat nga administrata | 7,200 | 8,000 | 8,500 | 9,000 |
| 2.4 | Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve | 10,300 | 15,000 | 15,800 | 16,300 |
| 2.5 | Te hyrat nga tatimi ne pronë | 71,537 | 104,589 | 107,980 | 114,520 |
| 2.6 | Të hyrat nga tatimi ne tokë | 30,482 | 22,916 | 23,515 | 24,669 |
| 2.7 | Regjistrimi i Automjeteve | 6,300 | 8,000 | 8,200 | 8,300 |
| 2.8 | Te hyrat nga shëndetësia | 6,900 | 8,000 | 8,500 | 9,000 |
| 2.9 | Te hyrat nga shërbimet e inspektimit | 4,200 | 5,000 | 5,500 | 6,000 |
| 2.10 | Të hyrat tjera | 1,100 | 4,550 | 5,050 | 5,550 |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | **TOTALI** | **1,877,346** | **2,199,836** | **2,314,841** | **2,430,662** |

## Tabela 2. Vlerësimet e hershme të buxhetit 2024

| Emri I Drejtorisë/Programit '000 euro | Viti buxhetor ( 2023) | | | | | Vlerësimi i hershëm Viti 1 (2024) | | | | | Vlerësimi i hershëm Viti 2 (2025) | | | | | Vlerësimi i hershëm Viti 3 (2026) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | P&M | M&Sh | Shpenz.komunale | Subvencione | Kapitali | P&M | M&Sh | Shpenz.komunale | Subvencione | Kapitali | P&M | M&Sh | Shpenz.komunale | Subvencione | Kapitali | P&M | M&Sh | Shpenz.komunale | Subvencione | Kapitali |
| Zyra e Kryetarit | 76.3 | 7.7 | 0.2 | 52 | | 84.9 | 9.3 | 0.2 | 52 | | 85.2 | 9.3 | 0.2 | 55 | | 85.6 | 9.3 | 0.2 | 60 | |
| K. Komunal | 59.4 | 4.0 | | | | 148.7 | 4.0 | | | | 148.7 | 4.0 | | | | 148.8 | 4.0 | | | |
| D. per planifikim urban, Gjeodezi dhe kadaster | 49.5 | 17.8 | | | 190 | 62.2 | 16.9 | | | 188 | 62.4 | 19.2 | | | 255 | 62.7 | 23.1 | | | 275 |
| D. per Administratë të përgjithshme | 85.7 | 47.1 | 7.2 | | 35 | 100.9 | 43.3 | 7.2 | | 15 | 101.3 | 43.3 | 7.2 | | 15 | 101.7 | 43.4 | 7.2 | | 15 |
| D. Buxhet dhe Financave | 63.9 | 7.9 | 0.1 | | | 76.4 | 8.2 | 0.1 | | | 76.7 | 8.2 | 0.1 | | | 77.0 | 8.2 | 0.1 | | |
| D. Ekon. Bujqesi, pyltari dhe turizem | 52.8 | 10.0 | 0.4 | | 80 | 64.8 | 10.0 | 0.4 | | 80 | 65.1 | 10.0 | 0.4 | | 100 | 65.3 | 10.0 | 0.4 | | 125 |
| D. Sherbimeve Publike | 53.9 | 38.8 | 13.6 | | 55 | 71.8 | 35.8 | 13.9 | | 55 | 72.0 | 39.8 | 14.6 | | 55 | 72.3 | 48.8 | 15.3 | | 85 |
| D. e Arsimit | 35.5 | 4.5 | | | | 41.3 | 4.5 | | | | 41.5 | 4.5 | | | | 41.6 | 4.5 | | | |
| D. e Shendetsise | 17.5 | 2.9 | | | | 21.2 | 3.2 | | | | 21.3 | 3.2 | | | | 21.4 | 3.2 | | | |
| ZKK | 6.9 | | | | | 7.7 | | | | | 7.7 | | | | | 7.7 | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| TOTALI: | 501.4 | 140.7 | 21.4 | 52 | 360 | 680 | 135.2 | 21.7 | 52 | 338 | 681.99 | 141 | 22.4 | 55 | 425 | 684.06 | 155 | 23.1 | 60 | 500 |
| Arsimi filor | 301.8 | 39.5 | 5.0 | | 10 | 380.8 | 39.5 | 5.0 | | 10 | 382.2 | 39.5 | 5.0 | | 10 | 383.5 | 39.5 | 5.0 | | 10 |
| Arsimi i mesem | 122.2 | 17.1 | 3.6 | | | 143.3 | 17.1 | 3.6 | | | 143.9 | 17.1 | 3.6 | | | 144.5 | 17.1 | 3.6 | | |
| QKMF | 234.2 | 37.6 | 5.7 | | 10 | 288.5 | 52.5 | 6.2 | | 10 | 289.5 | 55.5 | 6.2 | | 20 | 290.5 | 57.5 | 6.2 | | 35 |
| Mirqenia Sociale | 11.4 | 1.8 | 2.0 | | | 11.9 | 2.4 | 2.0 | | | 12.0 | 2.4 | 2.0 | | | 12.0 | 2.4 | 2.0 | | |
| SUB TOTALI | 1170.9 | 236.7 | 37.7 | 52 | 380 | 1505 | 246.7 | 38.5 | 52 | 368 | 1509.5 | 256 | 39.2 | 55 | 455 | 1514.7 | 271 | 39.9 | 60 | 545 |

### SPECIFIKACION

| BUXHETI KOMUNAL JUNIK | VITI 2023 (000 EURO) | VITI 2024 (000 EURO) | VITI 2025 (000 EURO) | VITI 2026 (000 EURO) |
|---|---|---|---|---|
| | 1,877 | 2,200 | 2,315 | 2,431 |

## IV. Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pas për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2023.
Kjo kornizë paraqet parashikimin 3 vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend rritës për vitin 2024 gjithashtu edhe për dy vitet tjera pasuese me një trend të rritjes për çdo vjet.
Grandet qeveritare kanë rritje për vitin 2024 gjithashtu me një trend te rritjes ne vitet pasuese të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i grandeve të MFPT.

**Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal**

Më datën 15.05.2023 kanë arritur limitet e para buxhetore për komunat për periudhën 2024/2026. Granti fillestar i Qeverisë për Komunën e Junikut është si vijon:

**Tabela nr. 3 Limitet fillestare sipas qarkores buxhetore 2024/01**

| Limiti fillestar | Granti i Arsimit | Granti i Shëndetësisë | Granti i Përgjithshëm | Gjithsej granti Komunal |
|---|---|---|---|---|
| 2024-Kufijtë e financimit | 544,726 | 343,227 | 1,103,827 | 1,991,780 |
| 2025-Parashikimet | 561,067.83 | 360,289 | 1,177,312 | 2,098,768 |
| 2026-Parashikimet | 577,900 | 378,408 | 1,246,358 | 2,202,666 |

**Tabela nr.4. Projeksioni i të hyrave Buxhetore nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake 2024/2026 të Komunës së Junikut**

| K. K. Junik | Buxheti - 2024 | Buxheti – 2025 | Buxheti – 2026 |
|---|---|---|---|
| Të hyrat nga granti qeveritar | 1,991,780 | 2,098,768 | 2,202,666 |
| Të hyrat vetanake | 208,056 | 216,073 | 227,996 |
| | | | |
| TOTALI | 2,199,836 | 2,314,841 | 2,430,662 |

Tabela nr. 5. Korniza afatmesme buxhetore 2024/2026 sipas kufijve fillestar

| K. K. Junik | Buxheti - 2024 | Buxheti - 2025 | Buxheti – 2026 |
|---|---|---|---|
| Paga dhe mëditje | 1,504,676 | 1,509,642 | 1,514,688 |
| Mallra dhe shërbime | 246,660 | 255,999 | 271,074 |
| Shpenzime komunale | 38,500 | 39,200 | 39,900 |
| Subvencione | 52,000 | 55,000 | 60,000 |
| Investime kapitale | 358,000 | 455,000 | 545,000 |
| | | | |
| TOTALI | **2,199,836** | **2,314,841** | **2,430,662** |
| | | | |
| Burimet e financimit | | | |
| Granti i Qeverisë | **1,991,780** | **2,098,768** | **2,202,666** |
| Të hyrat vetanake | **208,056** | **216,073** | **227,996** |
| | | | |
| TOTALI | 2,199,836 | 2,314,841 | 2,430,662 |

**Në tabelën vijuese pas pranimit te limiteve finale do te paraqesim shpërndarjen e buxhetit final sipas programeve për vitet 2024/2026**

## Strategjia e shpenzimeve sipas Drejtorive/Programeve dhe deklarata e misionit dhe qëllimeve

**ZYRA E KRYETARIT** **Kryetari: Ruzhdi Shehu**

**Deklarata e misionit:** Kryetari i komunës, përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj, udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij; ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e komunës; emëron dhe shkarkon zëvendësit dhe drejtorët e drejtorive; propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës; propozon zhvillimin komunal, planet rregullative e investuese, propozon Buxhetin komunal vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko - financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës; si dhe ndërmerr aktivitetet e tjera që i caktohen me statut, rregullore komunale apo akte të tjera ligjore dhe nën ligjore të cilat janë në fuqi.
Përgatitë të gjitha materialet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve etj. Gjithnjë me qëllim të arritjes të një qeverisje sa më të mirë, koordinon punën me të gjitha drejtoritë etj. Ofron çasje në dokumente zyrtare në mënyrë të arritjes së një transparence sa më të madhe në punë, etj.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi primar është që të gjitha kompetencat e Komunës të rregulluara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës të zbatohen në përpikëri në mënyrë që misioni i Komunës të shënoj shkallën sa më të lartë të performancës duke i realizuar me sukses qëllimet strategjike komunale.

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 84,933.02 | 85,243.47 | 85,553.91 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 9,300.00 | 9,300.00 | 9,300.00 |
| 3 | Komunalit | 150.00 | 150.00 | 150.00 |
| 5 | Subvencione | 52,000.00 | 55,000.00 | 60,000.00 |
| 6 | Kapitalet | - | - | - |
| | **TOTALI** | **146,383.02** | **149,693.47** | **155,003.91** |
| | **Numri I te Punësuarve** | 8 | 8 | 8 |

**ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL**

**Kryesuesi: Shpejtim Gacaferi**

Deklarata e misionit: Kuvendi i Komunës është organi më i lartë legjislativ i Komunës, i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.
Kuvendi i Komunës mund të miratoi aktet dhe të ndërmerr masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre e që vlejnë brenda territorit të Komunës dhe në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, dhe atë: statutin e Komunës; rregulloren e punës; rregulloret komunale; dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionimin e komunës.

Deklarata e qëllimit: Zhvillimi lokal ekonomik, planifikimi urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, afirmimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; ofrimin e për kujdesit publik shëndetësor, ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale; turizmin, aktivitet kulturore dhe të lira, çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre apo që nuk është përcaktuar ndonjë autoritet tjetër.

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 148,668.16 | 148,723.72 | 148,779.29 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 4,000.00 | 4,000.00 | 4,000.00 |
| 3 | Komunalit | - | - | - |
| 5 | Subvencione | - | | - |
| 6 | Kapitalet | - | - | - |
| | TOTALI | 152,668.16 | 152,723.72 | 152,779.29 |
| | Numri I te Punësuarve | 15 | 15 | 15 |

**DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME** **Drejtori: Leonora Shehu**

Deklarata e Vizionit: Ofrimi i shërbimeve efikase dhe të cilësisë së lartë, që u përgjigjen qytetarëve dhe i përmbushin nevojat e tyre.

Deklarata e Misionit: Udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet administrative – teknike të drejtorisë dhe ato të Shërbimit Civil Komunal që bien në këtë kompetencë. Udhëheqë me librat amë, të gjendjes civile, lëshon certifikata të gjendjes civile, sjellë aktvendime për regjistrime të mëvonshme, përmirësime dhe ndryshime të emrit e mbiemrit personal, harton aktet normative që bien në kompetencë të drejtorisë, udhëheq punën e arkivit komunal, zyrën e pritjes, sektorin teknik dhe të mirëmbajtjes, logjistikës, angazhohet dhe përcjellë punën e bashkëpunimit me vendbanimet dhe fshatrat. Gjithashtu kryen edhe punë të tjera që janë kompetencë e drejtorisë e që janë të bazuara në ligje, statut të Komunës, rregullore dhe udhëzime administrative, të cilat janë në fuqi.

Deklarata e Qëllimit: Koordinimi i punës me Drejtoritë Komunale në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Junikut. Pranimi i lëndëve nga palët dhe procedimi i tyre në zyrat e administratës Komunale, dhënia e informatave për palët lidhur me kërkesat dhe ankesat e tyre. Pajisja e palëve me kohë dhe në mënyrë transparente me dokumentacion personal nga librat e amzës. Përgatitja dhe plasimi me kohë në ueb-faqe të informatave për ecuritë, të arriturat dhe punën në Administratën Komunale si dhe shërbime të tjera që janë në kompetencë të drejtorisë në fjalë.

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 100,888.96 | 101,263.93 | 101,651.47 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 43,300.00 | 43,341.00 | 43,430.00 |
| 3 | Komunalit | 7,200.00 | 7,200.00 | 7,200.00 |
| 5 | Subvencione | | | |
| 6 | Kapitalet | 15,000.00 | 15,000.00 | 15,000.00 |
| | **TOTALI** | **166,388.96** | **166,804.93** | **167,281.47** |
| | **Numri I te Punësuarve** | 14 | 14 | 14 |

| Të hyrat vetanake | | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Te hyrat nga Administrata (Gjendja Civile LAL, LAM etj) | 8,000 | 8,500 | 9,000 |
| 2. | | | | |
| 3. | | | | |
| | TOTALI: | **8,000** | **8,500** | **9,000** |

**DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA** **Drejtori: Vjollca Qestaj**

Deklarata e Vizionit: Drejtoria për Buxhet dhe Financa do të jetë çdo herë e saktë në planifikime, e besueshme dhe transparente.

Deklarata e Misionit: Menaxhon dhe operon me mjetet buxhetore të Komunës, i siguron Drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon lidhur me aktualitetet e ndërlidhura me Buxhetin e Komunës. Përgatit raportet për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvend lidhur me menaxhimin e financave komunale, përgatitjen dhe prezantimin e Buxhetit, koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të drejtorisë, këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin. Gjithashtu, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa hyn edhe Zyra e Tatimit në pronë, e cila ka si mision inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë, që dedikohen për projekte kapitale, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Deklarata e Qëllimeve:

a) Planifikimi i saktë dhe efikas i Buxhetit
b) Shpenzimi i Buxhetit në mënyrë racionale dhe në përputhje me ligjet në fuqi
c) Rritja e inkasimit të të hyrave vetanake komunale

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 76,417.64 | 76,723.61 | 77,029.59 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 8,200.00 | 8,200.00 | 8,200.00 |
| 3 | Komunalit | 100.00 | 100.00 | 100.00 |
| 5 | Subvencione | - | - | - |
| 6 | Kapitalet | - | - | - |
| | **TOTALI** | **84,717.64** | **85,023.61** | **85,329.59** |
| | **Numri I te Punësuarve** | **9** | **9** | **9** |

| **Të hyrat vetanake** | | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| **1.** | Te hyrat nga Tatimi ne pronë | 104,589 | 107,980 | 114,520 |
| **2.** | Te hyrat nga Tatimi ne tokë | 22,916 | 23,515 | 24,669 |
| **3.** | Te hyrat nga regjistrimi i automjeteve | 8,000 | 8,200 | 8,300 |
| **4.** | Te hyrat tjera | 2,000 | 2,000 | 2,000 |
| | | | | |
| | TOTALI: | **137,505** | **141,695** | **149,489** |

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE INSPEKSIONI** **Drejtori: Demokrat Ganijaj**

Deklarata e misionit: Misioni i përgjithshëm i DSHP-së është realizimi i suksesshëm i Planit për Parandalimin e Emergjencave, reagimin e shpejtë dhe të suksesshëm ndaj emergjencave, intervenime të suksesshme të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, rritjen e performansës në Shërbimin e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, mirëmbajtja e pastërtisë së qytetit, rritjen e performansës në transportit publik të udhëtarëve, ndriçimin elektrik të qytetit si dhe rritjen e performansës në ndërmarrjet publike për menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi i drejtorisë do të jetë ndërtimi dhe riparimi i rrugëve të qytetit dhe atyre lokale, ndërtimi i rrjeteve të reja të ujësjellësit, ndërtimi i rrjeteve të reja të kanalizimit të ujërave të zeza, ndërtimi i parqeve, shesheve dhe sipërfaqeve të gjelbëruara, ndërtimi i rrjeteve të reja të ndriçimit publik.

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 71,835.29 | 72,033.02 | 72,268.64 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 35,800.00 | 39,800.00 | 48,800.00 |
| 3 | Komunalit | 13,850.00 | 14,550.00 | 15,250.00 |
| 5 | Subvencione | - | - | - |
| 6 | Kapitalet | 55,000.00 | 55,000.00 | 85,000.00 |
| | **TOTALI** | **176,485.29** | **181,383.02** | **221,318.64** |
| | **Numri I te Punësuarve** | 8 | 8 | 8 |

| Të hyrat vetanake | | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Te hyrat nga shërbimet e inspektimit | 5,000 | 5,500 | 6,000 |
| 2. | | | | |
| 3. | | | | |
| | TOTALI: | **5,000** | **5,500** | **6,000** |

**DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK** **Drejtori: Gentiana Tofaj**

Deklarata e Vizionit:
Zhvillimi, promovimit i turizmit dhe monumenteve kulturore do jetë qëllimi kryesor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, duke marrë parasysh resurset natyrore dhe historinë e qytetit.

Deklarata e Misionit:
Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, zhvillim të bujqësisë, pylltarisë dhe bletarisë, me qëllim tërheqjen e investitoreve për të krijuar një mjedis të favorshëm për qytetarët e Komunës së Junikut.

Deklarata e Qëllimeve:
Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, zhvillim të bujqësisë, pylltarisë dhe bletarisë, me qëllim tërheqjen e investitoreve për të krijuar një mjedis të favorshëm për qytetarët e Komunës së Junikut.
Projektet e hartuara do gjejnë zbatim në disa mënyra: Përmes investimeve kapitale (penda dhe kanale të ujitjes),Ofrimit të Shërbimeve Këshillimore, (ngritja e kapaciteteve të fermerëve në menaxhimin e fermave dhe aplikimin e teknologjive të avancuara në prodhimtarin bujqësore), mbështetjes për sektorin e blegtorisë, bletarisë, perimekulturës, pemëtarisë,dhe hulumtimi i burimeve financiare (garantëve dhe subvencione) për sektorin e bujqësisë dhe bletarisë, mbështetje për iniciativat e reja të fermerëve në prodhimtarin bujqësore (ngritjen e cilësisë dhe sasisë të prodhimeve bujqësore).
Ruajtja dhe ripyllëzimi i tokave pyjore, duke parandaluar dhe shëruar nga dëmtuesit dhe sëmundjet që i atakojnë.
Bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare, bizneset lokale dhe të jashtëm, drejt realizimit të projekteve zhvillimore komunale.

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 64,831.50 | 65,051.94 | 65,272.39 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 10,000.00 | 10,000.00 | 10,000.00 |
| 3 | Komunalit | 400.00 | 400.00 | 400.00 |
| 5 | Subvencione | | | |
| 6 | Kapitalet | 80,000.00 | 100,000.00 | 125,000.00 |
| | **TOTALI** | **155,231.50** | **175,451.94** | **200,672.39** |
| | **Numri I te Punësuarve** | **10** | **10** | **10** |

| Të hyrat vetanake | | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Te hyrat nga ushtrimi i veprimtarive te bizneseve | 15,000 | 15,800 | 16,300 |
| 2. | Ndërrimi i destinimit te tokës | 2,000 | 2,500 | 3,000 |
| 3. | | | | |
| | TOTALI: | **17,000** | **18,300** | **19,300** |

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MJEDISIT** **Drejtori: Zenun Shala**

Deklarata e Vizionit: Komunë e planifikuar dhe ndërtuar sipas planeve hapësinore duke ruajtur mjedisin dhe lehtësuar jetën e qytetarëve, me kadastër të digjitalizuar dhe shërbime në kohë reale.

Deklarata e Misionit: Zbatimi me përpikshmëri i planeve hapësinore , mjedisore dhe azhurnimi i kadastrit në vazhdimësi.

Deklarata e Qëllimeve: ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve duke respektuar normat teknike të ndërtimit, planifikimit, ato mjedisore dhe kadastrale.

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 62,208.39 | 62,447.62 | 62,686.85 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 16,860.00 | 19,156.00 | 23,144.00 |
| 3 | Komunalit | | | |
| 5 | Subvencione | - | - | - |
| 6 | Kapitalet | 188,000.00 | 255,000.00 | 275,000.00 |
| | **TOTALI** | **267,068.39** | **336,603.62** | **360,830.85** |
| | **Numri I te Punësuarve** | 7 | 7 | 7 |

| **Të hyrat vetanake** | | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Te hyrat nga Urbanizmi (lejet e ndërtimit) | 16,000 | 17,000 | 18,500 |
| 2. | Te hyrat nga shërbimet kadastrale | 16,001 | 16,028 | 16,157 |
| 3. | | | | |
| | TOTALI: | **32,001** | **33,028** | **34,657** |

**DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT** **Drejtori: Xhavit Velijaj**

**Deklarata e Vizionit**: DAKRS do të jetë gjithmonë korrekte dhe transparente në të gjitha synimet e saj për ngritjen e cilësisë së arsimit në komunën e Junikut.

**Deklarata e Misionit:** DAKRS, udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet arsimore – administrative- teknike të Drejtorisë dhe shkollave dhe është përgjegjëse për zbatimin e ligjshmërisë dhe aktet nënligjore në fushën e arsimit në nivel komunal..

**Deklarata e Qëllimeve:** DAKRS, Planifikon udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në drejtori, pjesëmarrjen në procesin e zgjedhjes dhe emërimit të personelit dhe drejtorit në shkollë; bën mbledhjen dhe analizën e informatave për të gjitha çështjet e sistemit në komunë; bën sigurimin e hapësirës së nevojshme shkollore për përfshirjen e të gjithë fëmijëve dhe të rriturve në shkollim; aftësimin e personelit të drejtorisë; transparencën dhe depolitizimin e arsimit; planifikimin dhe shfrytëzimin racional të buxhetit për arsimin komunal; komunikimin me prind dhe publikun për çështje që kanë të bëjnë me procesin arsimor në komunë; dhe punë tjera në fushën e arsimit që obligohet nga komuna dhe MASHT-i. Menaxhon, udhëheqë dhe kryen të gjitha punët përkitazi me lëmin e kulturës në Komunë, organizon punën dhe aktivitetet me rininë në të gjitha fushat, organizon jetën sportive dhe siguron kushte për zhvillimin e sportit.

Administrata, Drejtoria e Arsimit

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 41,283.95 | 41,460.07 | 41,633.52 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 4,500.00 | 4,500.00 | 4,500.00 |
| 3 | Komunalit | | | |
| 5 | Subvencione | | | |
| 6 | Kapitalet | | | |
| | **TOTALI** | **45,783.95** | **45,960.07** | **46,133.52** |
| | **Numri I te Punësuarve** | **5** | **5** | **5** |

Shkolla fillore '' EDMOND HOXHA''

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 380,900.27 | 382,255.22 | 383,527.70 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 39,500.00 | 39,500.00 | 39,500.00 |
| 3 | Komunalit | 5,000.00 | 5,000.00 | 5,000.00 |
| 5 | Subvencione | - | - | - |
| 6 | Kapitalet | 10,000.00 | 10,000.00 | 10,000.00 |
| | **TOTALI** | **435,400.27** | **436,755.22** | **438,027.70** |
| | **Numri I te Punësuarve** | **50** | **50** | **50** |

Shkolla e mesme '' KUVENDI I JUNIKUT''

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 143,303.64 | 143,889.26 | 144,529.56 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 17,100.00 | 17,100.00 | 17,100.00 |
| 3 | Komunalit | 3,600.00 | 3,600.00 | 3,600.00 |
| 5 | Subvencione | - | - | - |
| 6 | Kapitalet | | | |
| | **TOTALI** | **164,003.64** | **164,589.26** | **165,229.56** |
| | **Numri I te Punësuarve** | **18** | **18** | **18** |

**DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE** **Drejtori: Fatos Shala**

Deklarata e Misionit:
Misioni i DSHMS-së është zhvillimi dhe sigurimi i shërbimeve efektive për plotësimin e nevojave të popullsisë së Komunës. Sigurimi i kornizës menaxhuese për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore të qëndrueshme në nivelin primar shëndetësor, përmirësimi i vazhdueshëm kualitativ të shërbimeve shëndetësore.

Deklarata e Qëllimeve:
Përmirësimi i duhur i shëndetit të qytetarëve, parandalimi i sëmundjeve ngjitëse, imunizimi dhe vaksinimi, ofrimi i shërbimeve sa më cilësore dhe efikase në kujdesin primar shëndetësor.

Administrata, Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale

| | **Kategoritë buxhetore** | **2024** | **2025** | **2026** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 21,241.49 | 21,339.79 | 21,438.09 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 3,200.00 | 3,200.00 | 3,200.00 |
| 3 | Komunalit | | | |
| 5 | Subvencione | - | - | - |
| 6 | Kapitalet | - | - | - |
| | **TOTALI** | **24,441.49** | **24,539.79** | **24,638.09** |
| | **Numri I te Punësuarve** | **2** | **2** | **2** |

QKMF

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 288,545.43 | 289,541.12 | 290,536.81 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 52,500.00 | 55,500.00 | 57,500.00 |
| 3 | Komunalit | 6,200.00 | 6,200.00 | 6,200.00 |
| 5 | Subvencione | - | - | - |
| 6 | Kapitalet | 10,000.00 | 20,000.00 | 35,000.00 |
| | **TOTALI** | **357,245.43** | **371,241.12** | **389,236.81** |
| | **Numri I te Punësuarve** | **33** | **33** | **33** |

| **Të hyrat vetanake** | | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Te hyrat nga Shëndetësia | 8,000 | 8,500 | 9,000 |
| 2. | | | | |
| 3. | | | | |
| | TOTALI: | **8,000** | **8,500** | **9,000** |

Shërbimet sociale

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 11,949.77 | 11,993.95 | 12,038.14 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 2,400.00 | 2,400.00 | 2,400.00 |
| 3 | Komunalit | 2,000.00 | 2,000.00 | 2,000.00 |
| 5 | Subvencione | - | - | - |
| 6 | Kapitalet | - | - | - |
| | **TOTALI** | **16,349.77** | **16,393.95** | **16,438.14** |
| | **Numri I te Punësuarve** | **2** | **2** | **2** |

**ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE** **Udhëheqës:**

Deklarata e misionit:
Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryetarit, ndihmon në përpilimin e strategjisë së kthimit në nivel komunal. Harton informata lidhur me kthimet dhe ri integrimet në Komunë.

| | Kategoritë buxhetore | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe mëditje | 7,668.50 | 7,705.28 | 7,742.06 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | | | |
| 3 | Komunalit | | | |
| 5 | Subvencione | | | |
| 6 | Kapitalet | | | |
| | **TOTALI** | **7,668.50** | **7,705.28** | **7,742.06** |
| | **Numri I te Punësuarve** | **1** | **1** | **1** |

**Programi komunal i investimeve publike (PIP)**

Në tabelën e mëposhtme po paraqesim Listën e projekteve kapitale të parapara me Buxhetin e vitit 2023, me financim nga të hyrat e fondit të ndarë për Komunën e Junikut, si dhe Listën e projekteve për vitet 2024/2026 të parapara me financim nga të hyrat vetanake dhe nga donatoret. Kjo listë mund të modifikohet me propozime të reja që do të vinë nga Drejtoritë gjatë shqyrtimit me Drejtorët e Drejtorive, palët e interesit, strukturat tjera udhëheqëse dhe organeve relevante komunale për hartimin e politikave zhvillimore të Komunës duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara për financim si dhe aftësive dhe burimeve të ardhurave komunale, si dhe Grandet e Qeverisë, Participimet e qytetarëve dhe Donatorët e ndryshëm.

| Nr. | Përshkrimi i projektit | Drejtoria | Burimi i financimit | Shuma totale e financimit | Financimi sipas viteve ('000 euro) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 2023 Buxheti | 2024 | 2025 | 2026 |
| 1 | Bashkëfinancim i projekteve | DZHE | KK. Junik | 326.4 | 106.4 | 60 | 70 | 90 |
| 2 | Rehabilitimi i rrugëve lokale | DSHPMI | KK. Junik | 70 | 15 | 15 | 20 | 20 |
| 3 | Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Topilla-Gaxherr | DZHE | KK. Junik | 20 | 20 | | | |
| 4 | Hapja e rrugëve fushore lokacioni Trojet, Shafrane dhe Gjocaj | DZHE | KK. Junik | 45 | 10 | 20 | 15 | |
| 5 | Rregullimi i hapësirave sportive, rekreative, dhe te ambientit në shkollën fillore "Edmond Hoxha" | DAKRS | KK. Junik | 60 | 10 | 20 | 20 | 10 |
| 6 | Ndërtimi i kanalizimit sekondar. | DUKM | KK. Junik | 150 | 50 | 50 | 50 | |
| 7 | Asfaltimi i rrugës lokale Junik - Jasiq | DSHPMI | KK. Junik | 145 | 14,050 | | | |
| 8 | Ndërtimi i rrethojës dhe rregullimi i oborrit në QKMF dhe QPS. | DSHMS | KK. Junik | 30 | 10 | 10 | 10 | |
| 9 | Rekonstruimi i rrugës Gaxherr- Bajraktar | DKUM | KK. Junik | 140 | 140 | | | |
| 10 | Blerja e automjetit për nevoja të komunës | DAP | KK. Junik | 20 | 20 | | | |
| 11 | Furnizim me gjenerator për objektin e komunës | DAP | KK. Junik | 20 | 20 | | | |
| 12 | Ndriçimi i hapësirave publike përreth lumit Erenik | DSHPMI | KK. Junik | 40 | 20 | 10 | 10 | |
| 13 | Ndërtimi i shtegut për biçikleta përreth lumit Erenik | DSHPMI | KK. Junik | 40 | 10 | 15 | 15 | |
| 14 | Hapja dhe rregullimi i rrugës në fshatin Gjocaj | DSHPMI | KK. Junik | 10 | 10 | | | |
| 15 | Furnizimi me pajisje për analiza laboratorike në QKMF | DSHMS | KK. Junik | 5 | 5 | | | |
| 16 | Kanalizimi i ujërave të zeza lokacioni Miroc dhe Lagja Krasniq | DKUM | KK. Junik | 105 | 55 | 50 | | |
| 17 | Ndërtimi i mureve mbrojtëse lokacioni Tofaj dhe Pepsh | DSHPMI | KK. Junik | 20 | 20 | | | |
| 18 | Ndërtimi i kanaleve të ujitjes | DZHE | | 100 | | 40 | 40 | 20 |
| 19 | Ndërtimi i sheshit të Qendrës të Komunës së Junikut | DUKM | | 245 | | 200 | 45 | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 20 | Ndërtimi i objektit të Shkollës Fillore | DAKRS | MAKRS | 650 | | | | |
| 21 | Ndërtimi i çerdhës për fëmijë | DAKRS | **MASHTI** | 120 | 60 | 60 | | |
| 22 | Ndertimi i Objektit social për banim | DSHMS | | 245 | | 200 | 45 | |
| 23 | Ndërtimi i ashensorit në objektin e komunës | DAP | **KE** | 25 | | 25 | | |
| 24 | Hartimi i hartave zonale | DUKM | | 20 | | 10 | 5 | 5 |
| 25 | Ndërtimi i rrethojës së stacionit të Autobusëve | DZHE | | 25 | | | 25 | |
| 26 | Ndërtim i parqeve dhe këndeve të lojërave për Fëmijë | DUKM | | 70 | | 10 | 30 | 30 |
| 27 | Ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse përgjatë rrugës së Bjeshkës | DSHPMI | | 1,000 | | 500 | 300 | 200 |
| 28 | Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Lagjen Agim Ramadani | DSHPMI | | 100 | | 50 | 50 | |
| 29 | Hapja, Gjurmimi dhe Vënia në funksion e vendbanimit të periudhës së bronzit për vizitorët "Gropa e Amonit" | DAKRS | | 50 | | 20 | 15 | 15 |
| 30 | Restaurimi dhe vënia në funksion e monumenteve të vjetra si: Kullat, Mullinjtë dhe Valavicat | DAKRS | | 300 | | 100 | 100 | 100 |
| 31 | Ndërtimi i tregut të gjelbër | DZHE | | 80 | | 80 | | |
| 32 | Ndërtimi i zonës për kamping | DZHE | | 50 | | 25 | 20 | 5 |
| 33 | Ndërtimi i pishinave verore | DZHE | | 200 | | | 100 | 100 |
| 34 | Kompleksi rekreativ në Livadhin e Madh | DZHE | | 50 | | 250 | 250 | |
| 35 | Ndërtimi i objektit për Trashëgimi kulturore/muzeu i qytetit | DAKRS | | 600 | | 200 | 200 | 200 |
| 36 | Inkubator biznesi | DZHE | | 250 | | 150 | 100 | |
| 37 | Hapja dhe sinjalizimi i shtigjeve të reja për ecje qarku Moronicë- Zharre | DZHE | | 30 | | 20 | 10 | |
| 38 | Rekonstruimi i rrugës "Junik - Rastovic" | DUKM | | 1,200 | | 500 | 500 | 200 |
| 39 | Asfaltimi, kanalizimi dhe ujësjellësi në fshatin Gjocaj, Jasiq | DUKM | | 200 | | 50 | 100 | 50 |
| 40 | Ndërtimi i objektit të Gjykatës komunale | DAP | | 600 | | 300 | 300 | |
| 41 | Ndertimi I objektit të stacionit të Policisë | DSHPMI | | 400 | | 200 | 200 | |
| 42 | Ndërtimi i linjës Via-Ferrata në Lokacionin "Shkëmbi i Jedovës" | DZHE | | 30 | | 10 | 10 | 10 |
| 43 | Ndërtimi i fushës sportive në SHFMU "Edmond Hoxha" | DAKRS | | 50 | | 50 | | |
| 44 | Rregullimi i planeve të hollësishme të komunës | DUKM | | 75 | | 25 | 25 | 25 |
| 45 | Ndërtimi i ujëmbledhësve në Komunën e Junikut | DUKM | | 2,500 | | 1,000 | 1,000 | 500 |
| 46 | Ndërtimi i Ashensorit në QKMF | DSHMS | | 30 | | 30 | | |
| 47 | Ndërtimi i rrjetit elektrik efiqient lokal | DSHPMI | | 30 | | 10 | 20 | |
| 48 | Zërimi i asamblesë komunale | DAP | | 15 | | 15 | | |
| 49 | Hapja dhe trasimi i rrugëve malore | DZHE | | 20 | | 10 | 10 | |
| 50 | Ndërtimi i tranzitit Botushë-Nivokaz-Dobrosh- Pacaj- Hereq | DUKM | | 300 | | 100 | 100 | 100 |
| 51 | Ndërtimi i palestrës sportive në Junik | DAKRS | | 700 | | | 350 | 350 |
| 52 | Pyllëzimi i hapësirave të zhveshura | DZHE | | 120 | | 40 | 40 | 40 |
| 53 | Rregullimi i shtratit të lumit Erenik Nivokaz – Qafa e Jasiqit (L=4200m) | DUKM | | 2,000 | | 1,000 | 500 | 500 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 54 | Ruajtja, Sanimi dhe Rregullimi i burimeve të ujit të pijes në Ekofshatrat-Bjeshke | DZHE | | 30 | | 30 | | |
| 55 | Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave rekreative dhe sportive përgjatë lumit Erenik | DSHPMI | | 200 | | 30 | 70 | 100 |
| 56 | Themelimi i zonës ekonomike për investitorë të huaj | DZHE | | 300 | | 150 | 150 | |
| 57 | Ndërtim i trotuarit në rrugën Gaxherr- Bajraktar - Pepsh | DUKM | | 100 | | 50 | 50 | |
| 58 | Ndërtimi i palestrës sportive në Gjimnazin "Kuvendi i Junikut" | DAKRS | | 500 | | 200 | 200 | 100 |
| 59 | Infrastruktura rrugore për persona me mobilitet të zvogëluar | DSHPMI | | 5 | | 5 | | |
| 60 | Ndërtimi i kompleksit të dëshmorëve | DUKM | | 100 | | 50 | 50 | |
| 61 | Ndërtimi i pendës së ujitjes në Qafë të Jasiqit-Tofaj- Pepsh | DZHE | | 50 | | 50 | | |
| 62 | Kanalet e ujitjes në Bramatoqje | DUKM | | 200 | | 100 | 100 | |
| 63 | Rekonstruimi i urës së Gurit lokacioni Moronicë. | DUKM | | 30 | | 30 | | |
| 64 | Zgjerimi i rrugës "Qendër-Shkollë Fillore- Pepsh- Teqja Halvetije Xhaferije" | DUKM | | 400 | | 200 | 200 | |
| 65 | Ndërtimi i pallatit të kulturës | DAKRS | | 1,500 | | | 1.500 | |
| 66 | Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës së Turbisë | DUKM | | 200 | | 100 | 100 | |
| 67 | Rregullimi i shëtitores përgjatë lumit Trava | DUKM | | 200 | | 100 | 100 | |
| 68 | Rregullimi i kanaleve të ujitjes në lagjen Hoxhë deri ne Fidanishtë | DZHE | | 60 | | 30 | 30 | |
| 69 | Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i varrezave | DSHPMI | | 100 | | | 50 | 50 |
| 70 | Gjelbërimi i hyrjeve të qytetit të Junikut me drunjë dekorativ | DSHPMI | | 15 | | 5 | 5 | 5 |
| 71 | Rregullimi i hapësirave tek parku Moronica | DUKM | | 55 | | 55 | | |
| 72 | Shndërrimi i hapësirave përgjatë lumit Erenik në zona rekrative | DSHPMI | | 25 | | 10 | 15 | |
| 73 | Hapja dhe shënjëzimi i shtigjeve të ecjes për tek Kanioni i Erenikut | DZHE | | 5 | | | 5 | |
| 74 | Vendosja e kabinave pritëse në stacione nëpër lagje | DSHPMI | | 10 | | 5 | 5 | |
| 75 | Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi i rrugës Qendër-Lagjja Agim Ramadani | DUKM | | 300 | | 100 | 100 | 100 |
| 76 | Hapja dhe sinjalizimi i shtigjeve në parkun Moronica | DZHE | | 30 | | 10 | 20 | |
| 77 | Ndërtimi i Depos së Komunës | DAP | | 5 | | 5 | | |
| 78 | Renovimi i objektit të komunës | DAP | | 50 | | 50 | | |
| 79 | Ndërtimi i shtegut në brendi të Kanionit të Junikut me material metalik dhe druri | DZHE | | 15 | | 10 | 5 | |
| 80 | Ndërtimi i pikave vrojtuese panoramike në Bjeshkët e Junikut | DZHE | | 25 | | 10 | 10 | 5 |
| 81 | Hapja dhe Rregullimi i shtegut për lëshim me Biçikleta "Livadhi i Bahqit-Livadhi i Verrave" | DZHE | | 10 | | | 10 | |
| 82 | Ndërtimi i shtegut për biçiklista | DSHPMI | | 10 | | 10 | | |
| 83 | Rregullimi i kanaleve të ujitjes në lagjen Malok i poshtëm | DZHE | | 20 | | | 10 | 10 |
| 84 | Instalimi i pompave termike në objektin e Komunës së Junikut | DSHPMI | | 50 | | 25 | 25 | |
| 85 | Instalimi i pompave në objektet e Institucioneve tjera Publike në Komunën e Junikut | DSHPMI | | 200 | | 50 | 50 | 100 |
| 86 | Ndërtimi i Liqenit artificial | DZHE | | 3.500 | | 1,000 | 1,000 | 1.500 |
| 87 | Ndërtimi i Qendrës së skijimit | DZHE | | 240 | | 140 | 100 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 88 | Ndërtimi i pikave grumbulluese të produkteve bujqësore | DZHE | 30 | | 15 | 15 | |
| 89 | Ndërtimi i Bujtinave Turistike | DZHE | 150 | | 50 | 50 | 50 |
| 90 | Blerja e Autoambulancës dhe pajisjeve mjekësore | DSHMS | 35 | | | 35 | |
| 91 | Hartimi i planeve rregulluese Urbane për Gryken e Erenikut me lokalitetet: Gradinë, Jedovë, Liqejt e Gjeravicës dhe Rrasa e Zogut. | DUKM | 100 | | 50 | 50 | |
| 92 | Parku i Paqes në kufirin Shqipëri-Kosovë-Mali i zi (ndërtimi i kampingut) | DUKM | 150 | | 100 | 50 | |
| 93 | Vendosja e shtyllave elektrike dhe ndriçimi publik në lagjen Bramatok | DSHPMI | 50 | | | 50 | |
| 94 | Ndërtim i impianteve të ujerave të zeza dhe trajtimi i tyre. | DUKM | 1,200 | | 500 | 500 | 200 |
| 95 | Ndërtimi i rrugës Gropa e Erenikut Bogiqe (Kufiri Kosovë-Shqipëri-Mali i zi) | DUKM | 800 | | 200 | 300 | 300 |
| 96 | Studimi i Fizibilitetit për shtrirjen e nxemjës qendrore në Qytetin e Junikut. | DUKM | 300 | | 150 | 150 | |
| 97 | Hapja e Rrugëve fushore Qafa e Jasiqit-Firza | DSHPMI | 30 | | 15 | 15 | |
| 98 | Rregullimi dhe kyçja në kanalizim për lagjen Miroc | DSHPMI | 60 | | 30 | 30 | |
| 99 | Ndërtimi i fushës se Futbollit | DAKRS | 300 | | | 150 | 150 |
| 100 | Rikonstruimi i objektit të shkollës së vjetër | DAKRS | 500 | | | 300 | 200 |
| 101 | Ndërtimi i rrjetit elektrik në lagjen Isufaj-Moronicë | DSHPMI | 30 | | 15 | 15 | |
| 102 | Ndërtimi i shtigjeve për këmbësor në rrugët e Junikut. | DSHPMI | 50 | | 50 | | |
| 103 | Rregullimi i kanaleve të ujërave të zeza në lagjen Pepsh | DSHPMI | 30 | | 15 | 15 | |
| 104 | Vazhdimi i kanaleve të ujitjes në lagjen Miroc | DZHE | 50 | | 25 | 25 | |
| 105 | Ndërtimi i kanalit të ujitjes nga Shkolla Fillore deri në lagjen Kuka | DZHE | 20 | | 10 | 10 | |
| 106 | Ndërtimi i tretoarëve segmenti Qendër-Kallavaj | DSHPMI | 100 | | 50 | 50 | |
| 107 | Studimi i fizibilitetit për Bjeshkët e Junikut | DUKM | 200 | | 100 | 100 | |
| 108 | Studimi i fizibilitetit për shtratin e lumit Erenik | DUKM | 60 | | 60 | 60 | |
| 109 | Rikonstruimi i kanalit kullues te Valavica | DUKM | 20 | | 10 | 10 | |
| 110 | Ndriçimi i hapsirave publike në lagje dhe fshatra. | DSHPMI | 50 | | 30 | 20 | |
| 111 | Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Junik- Rastavicë. | DUKM | 1,200 | 400 | 400 | 400 | |
| 112 | Funksionalizimi i impianteve të ujërave të zeza lokacioni Berishë dhe Gaxherr. | DSHPMI | 100 | | 30 | 30 | 40 |
| 113 | Zhvillimi i Infrastrukturës së Integruar në fshatrat Gjocaj dhe Jasiq | DSHPMI | 50 | | 10 | 20 | 20 |
| 114 | Ndërtimi i trotuareve në rrugët kryesore | DSHPMI | 30 | | 10 | 10 | 10 |
| 115 | Rregullimi dhe rrafshimi i vendit për mbeturinat inorte në lokacionin " Prroni i kalbt", si dhe rrethimi i tij. | DSHPMI | 50 | | 10 | 20 | 20 |
| 116 | Rikonstruimi i urave në Lumin Erenik | DSHPMI | 10 | | 5 | 5 | |
| 117 | Parku i aventurave në Moronicë | DZHE | 100 | | 80 | 20 | |
| 118 | Strehimore për Qentë Endacak | DZHE | 50 | | 25 | 25 | |
| 119 | Ndërtimi i rrjetit te kanalizimit ne Kallavaj | DUKM | 60 | | 30 | 30 | |
| 120 | Ndërtimi i kanalit rreth lapidarit në Lagjen Qok | DZHE | 50 | | 30 | 20 | |
| 121 | Rregullimi i oborrit të zjarrfikësve | DSHPMI | 20 | | 10 | 10 | |
| 122 | Zyra për Informim Turistik | DZHE | 30 | 20 | 10 | | |
| 123 | Ndërtimi i parqeve dhe këndit të lojërave për fëmijë | DUKM | 50 | | 10 | 20 | 20 |
| 124 | Ndërtimi i kompleksit të dëshmorëve | DUKM | 100 | | | 50 | 50 |
| 125 | Ndërtimi i ujëmbledhësve në Komunën e Junikut | DUKM | 2,500 | | 1,000 | 1,000 | 500 |
| 126 | Ndërtimi i parkingut nëntokësor | DUKM | 350 | | 200 | 100 | 50 |
| 127 | Hartimi i projektit për ndërtimin e ujëmbledhësit dhe rrjetit të | DUKM | 35 | | 35 | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ujitjes në Junik | | | | | | | | |
| 128 | Studimi i fizibilitetit për lokalitetin arkeologjik Gradina | DUKM | | 10 | | | 10 | |
| 129 | Ndërtimi i kanalit të ujitjes lokacioni Pepsh Bajraktar | DUKM | | 80 | | 50 | 30 | |
| 130 | Funksionalizimi i pendës së Bramatoqeve lokacioni nën Jaruha | DUKM | | 50 | | 50 | | |

P. S. Vlerat e prezantuar në tabelë janë të shprehura në mijë (000) euro.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa
Vjollca Qestaj

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| REFERENC-Ë: | Numër: 05-02/23 |
| PËR/ZA/TO: | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik |
| NGA/OD/FROM | Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A | 31.05.2023 |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

**PROCESVERBAL:**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së pestë (5) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 31.05.2023, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e komunës së Junikut z.Ruzhdi Shehu, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marin pjese te 13 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj.Leunora Shehu-AD, znj.Vjollca Qestaj-DBF, znj.Gentiana Tofaj-DZHE, z.Xhavit Velijaj DAKRS, z.Fatos Shala-DSHMS dhe z.Zenun Shala DUKM

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK
5. Ermelinda Llolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Llolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. **Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV (Mungon)**
14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV
15. **Xhemë Tofaj-Anëtar LVV (Mungon)**

**Rendi i ditës i paraparë**

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për formimin e grupit të Grave të Komunës së Junikut.
4. Informatë rreth Qarkores Buxhetore 2024/01.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së qytetarit z.Sami Jasiqi për ndërrimin e destinimit nga destinimi i planifikuar "Palestër Sportive-stadion", prodhimtari ( industri e lehtë dhe ushqimore ) në Lagje banimi individual me etazhitet B+P+1E dhe Afarizëm sipas projektit ideor.
6. Shfuqizimi i Vendimit nr:02/10/23 i dt:27.01.2023 për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar në Kuvendin Komunal.
7. Ndryshim plotësimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut 02/23/23 për Projekt-Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për Vitin 2023 sipas rekomandimeve të Ministrisë dhe
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

z.Dervish Bajraktari, përshëndetje për te gjithë, ne mbledhjen e fundit te KPF_së këtë pikën shfuqizimi i vendimit e kemi pasur si pikë te rendit te ditës dhe e kemi kaluar për ne kuvend, sot nuk e kemi si pikë te rendit te ditës por si kërkesë për pikë shtesë çka është ne pyetje.

z.Shpejtim Gacaferi, ne mbledhjen e KPF_së e kam hedhur ne votim dhe ju anëtarët e KPF_së keni thënë se nuk jeni te gatshëm ta votoni po te kalon për ne kuvend dhe aty te merret vendim, tash e keni ne mbledhjen e Kuvendit dhe po e qesim si pike te rendit te ditës, sikur te kishit votuar për ne mbledhjen e KPF_së sot do ta kishim si pikë te rendit te ditës. E qes ne votim rendin e ditës te propozuar, për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës u miratua.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje.

z.Shpejtim Gacaferi, ne mbledhjen e pestë (5) Maj-2023 mungojnë dy anëtarët e Kuvendit, z.Lulzim Gacaferi –LVV dhe z.Xhemë Tofaj-LVV, te cilët me kane informuar se do te mungojnë për ketë mbledhje.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, e qes ne votim procesverbalin e mbledhjes se kaluar, kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes se kaluar u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për formimin e grupit të Grave të Komunës së Junikut.

Shqyrtimin dhe arsyetimin e kësaj pike para anëtarëve te kuvendit e beri z.Shpejtim Gacaferi.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, e qes ne votim kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se pika e tretë e rendit te ditës u miratua.

4. Informatë rreth Qarkores Buxhetore 2024/01.

Shqyrtimin dhe arsyetimin e kësaj informate rreth qarkores Buxhetore 2024/01 e bëri znj.Vjollca Qestaj, drejtoreshë e DBF e cila fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroj dhe e arsyetoi para anëtarëve te kuvendit. Informatë rreth Qarkores Buxhetore 2024/01.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, kalojmë ne pikën e radhës se rendit te ditës.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së qytetarit z.Sami Jasiqi për ndërrimin e destinimit nga destinimi i planifikuar "Palestër Sportive-stadion", prodhimtari ( industri e lehtë dhe ushqimore ) në Lagje banimi individual me etazhitet B+P+1E dhe Afarizëm sipas projektit ideor.

Shqyrtimin dhe arsyetimin e beri z.Zenun Shala, drejtor i DUKM i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë më pas e sqaroi dhe e arsyetoi kërkesën së qytetarit z. Sami Jasiqi për ndërrimin e destinimit nga destinimi i planifikuar "Palestër Sportive-stadion", prodhimtari ( industri e lehtë dhe ushqimore ) në Lagje banimi individual me etazhitet B+P+1E dhe Afarizëm sipas projektit ideor para anëtarëve te kuvendit.

z.Leonard Llolluni, përshëndetje për te gjithë, me qen se ne si grupe i AAK kemi qene edhe shtytës për marrjen e këtij vendimi për investitorin z.Sami Jasiqi, qe të avancoj përpara me projektin e tij ne do ta mbështesim dhe jemi pro, por jo vetëm ketë por do te jemi pro për te gjithë investitorët junikas qe duan te investojnë për te mirën e qytetarëve Junikas. Dhe sa për kujtim për ty kryesues, ne mbledhjen qe kemi diskutuar për ketë Projekt ju e patët lëshuar mbledhjen dhe patët thënë se përmbani konflikt interesi a sot po shoh se nuk po e lëshoni mbledhjen po qëndroni.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje për te gjithë, ne si grup i LDK_se e përkrahim kërkesën e z.Sami Jasiqi.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, e qes ne votim kërkesën e z.Sami Jasiqi, kush është për? për 12 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 1 votë, konstatoi se kërkesa e qytetarit z.Sami Jasiqi për ndërrimin e destinimit nga destinimi i planifikuar "Palestër Sportive-stadion",

prodhimtari ( industri e lehtë dhe ushqimore ) në Lagje banimi individual me etazhitet B+P+1E dhe Afarizëm sipas projektit ideor.

6. Shfuqizimi i Vendimit nr:02/10/23 i dt:27.01.2023 për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar në Kuvendin Komunal,

Sqarim dhe e arsyetimin e Shfuqizimi i Vendimit nr:02/10/23 i dt:27.01.2023 për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar në Kuvendin Komunal para anëtarëve te kuvendit e beri z.Zenun Shala, drejtor DUKM.

z.Sadri Krasniqi, ne si grup i LDK_së jemi pro shfuqizimit te këtij vendimi.

z.Leonard Llolluni, ne nuk kemi kurrfarë materiali lidhur me shfuqizimin e këtij vendimi, dhe meqëse ky vendim paska qene i jashtëligjshëm, pse duhet te shfuqizohet?

z.Shpejtim Gacaferi, vendimin e kemi marrë ne këtu ne kuvend, përgjigje nga ministria për ketë vendim nuk kam.

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje per te gjithë, qëllimi është qe te bëjmë zgjedhje dhe te hapim shteg ligjor për investim, dhe problemi është se vendimi i marrur ne janar te këtij viti nuk mundet te zbatohet ne aspektin ligjor prandaj për mos me e lënduar atë aspekt fare, u mor vendimi sot për destinim nga ndërtimi industria ushqimore, palestra sportive qe është e përcaktuar ne PZHK te viti 2009 dhe ne plani shvillimor urban te viti 2011 ka qenë e pa nevojshëm te merret ai vendim i Janarit, tani është marë vendim sot, dhe ketë vendim te sotit do ta zbatoje drejtori i DUKM, dhe vendimi i sotit qe ju si kuvend e morët ka zbatim ligjorë dhe i hap rrugë investitorit te i lëshohen se pari kushtet e ndërtimit e me pas edhe leje ndërtimore.

z.Leonard Llolluni, kryetari po harron se çka ka folur ne mbledhjen e Janarit, ne mbledhjen e janarit ke thënë duhet me prit se PZHK ka kaluar gabimisht, keni thënë se hartat zonale ende nuk janë ne fuqi kur te kalojnë këto harta atëherë nuk kemi nevoje për ketë vendim sepse e kryejmë përmes komunës. Por kryetar, fakti është se PZHK aktuale është ligjërisht e zbatueshme deri sa te kaloj PZHK e re, dhe ne bazë te kësaj është dashur ti kthehet përgjigje investitorit dhe ajo punë te kryhet dhe te mos vije gjendja deri këtu.

z.Ruzhdi Shehu, kam thënë se rishikimi i PZHKse bëhet çdo 10 vite ka hyrë ne proces ne vitin 2021, ka qene ne rishikim prandaj nuk ka përfunduar, sepse ka mundur qe kjo çështje te përfundohet edhe me ketë, dhe me qenëse rishikimi i PZHK_së do te vonohet, dhe me qen se me PZHK qe është ne fuqi kemi mundësit ligjore qe ti japim rrugë investitorit, e vetmja gjë e ligjshme është vendimi për predestinimin e tokës ndërtimore nga ndërtimi industri e letë ushqimore, rekreativo- sportive dhe gjelbërim ne ndërtim banimi, kjo është e tera.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes në votim shfuqizimin e vendimit, kush është për? për 12 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 1 votë konstatoi se Shfuqizimi i Vendimit

nr:02/10/23 i dt:27.01.2023 për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar në Kuvendin Komunal, u miratua.

7. Ndryshim plotësimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut 02/23/23 për Projekt-Rregulloren për Taksa, ngarkesa dhe Gjoba Komunale për Vitin 2023 sipas rekomandimeve të Ministrisë

Sqarimin dhe arsyetimin e Ndryshim plotësimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut 02/23/23 për Projekt-Rregulloren për Taksa, ngarkesa dhe Gjoba Komunale për Vitin 2023 sipas rekomandimeve të Ministrisë para anëtarëve te kuvendit e beri znj.Vjollca Qestaj, drejtoreshë e DBF.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes ne votim ketë pikë kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se Ndryshim plotësimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut 02/23/23 për Projekt-Rregulloren për Taksa, ngarkesa dhe Gjoba Komunale për Vitin 2023 sipas rekomandimeve të Ministrisë u miratua.

8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

z.Leonard Llolluni, ne mbledhjen e kaluar kam kërkuar qe te na i sjellni faturat për dreka zyrtare, që drejtoresha ka thënë se janë borgje nga qeveria e kaluar.

znj.Vjollca Qestaj, unë nuk japi përgjegjësi për atë se si ti e kupton por jap përgjegjësi për atë qe e them, unë kam thënë se janë fatura ti vitit te kaluar 2022. Këto munden te vërtetohen edhe ne baze te ingjezimit por dhe ne bazë te procesverbalit.

z.Leonard Llolluni, sikur drejtoresha mos te thoshte se janë borgje te qeverisë se kaluar unë nuk do i kisha kërkuar ato fatura dhe arsyeja qe unë i kam kërkuar është se drejtoresha ka thënë se janë borgje te qeverisë se kaluar.

z.Dervish Bajraktari, kryesues ti po thua se do te marr masa për ata anëtar te kuvendi qe ndërhynë gjate fjalimit te anëtarit tjetër te kuvendit, atëherë mer masa edhe ndaj grupit te LDK_së sepse këta gjatë gjithë fjalimit qe ne marim po ndërhynë dhe po na përqeshin.

z.Zenel Maloku, unë i kam disa pyetje për kryetarin meqë është këtu, kam dëgjuar qe do të ndërtohet ura për ne fshatin Jasiq afër restorantit te z.Halil Jasiqi, a është kjo e vërtet? pyetja tjetër është po ashtu e dëgjuar se një operator ekonomik ka fituar tenderin për ndërtimin e rrugës ne "Gjocaj" atje ku e kam ngritur shume here si çështje, dhe unë e kam një kërkesë se kur te ndërtohet ajo rrugë te ndërtohet edhe një kanal aty sepse si fshat kemi shume nevojë për ketë kanal.

z.Dervish Bajraktari, çështja është se a keni planifikuar projekt për ndriçim publik, sepse nganjëherë funksionojnë dritat nganjëherë nuk po funksionojnë dritat, dhe çështja tjetër ka te beje me një kanal te ujitjes qe e keni ndërtuar ne lagjen "Shalaj", e kam parë qe ai është kanali më i kotë dhe shpenzimet më të kota qe keni berë, kanali gjendet afër varrezave te kësaj lagje dhe me ate kanal nuk ujit asnjë banorë, dhe po me intereson a ka pasur kërkesë apo si qëndron çështja.

z.Leonard Llolluni, pyetje për postimin e lajmeve ne "facebook" e komunës se Junikut, dhe ne postimin e fundit qe ka te beje me riasfaltimin e rrugës Bajraktar-Shalaj-Gaxherr kishit berë politikë dhe keni cekur se ndërtimi i kësaj rruge nga qeveria e kaluar ka qenë me cilësi te dobët, por ne te gjithë e dimë se atë rrugë e frekuentojnë automjete me kubikazhë të rendë, dhe nëse doni qe te bëni kështu politikë ju duhet ta cekni edhe cilësinë e rrugës "Jasiq- Gjocaj" qe është ndërtuar qe gjashtë muaj.

z.Mursel Salihaj, ne lagjen Berishë afër marketit ne berishë te ura, është një kanal i ujitjes i mbyllur nga marketi ne drejtim te hallës se sportit po bllokohet shumë shpesh dhe do ishte mirë qe te ndermerni diçka qe ky kanal te jete funksional dhe te mos bllokohet.

z.Ruzhdi Shehu, sa i përket kanaleve te ujitje ne e kemi planifikuar për ketë vit buxhetin dhe ne ketë kuvend është miratuar dhe i kemi ndarë investimet se nga do te shkojnë ndërtimi i tyre dhe për ketë vit nuk ka te planifikuar qe te ndërtohet kanal ne atë pjese qe po e ceke z.Zenel Maloku, ndërsa sa i përket rrugës po do te ndërtohet por fillimisht duhet te kryhet procedura e shpronësimit pa u kryer shpronësimi asnjë investim nuk shkon, ndërsa sa i përket ndërtimit te urës ajo është ne proces jemi duke i pritur disa leje ujore, është brenda afatit ligjor por edhe deri sa te behet elaborati ekologjik nuk do te mundemi ta fillojmë ndërtimin.

z.Zenun Shala, përgjigje për z.Dervish Bajraktari, ndërtimi i atij kanali qe ju e përmendet nuk është kanal i ujitjes por është kanal atmosferik qe ti barte ujërat e shiut apo edhe ujërat tjera qe bëhen nga ujitja e tokave dhe qe te mos dali mbi asfalt ne kemi ndërtuar ketë kanal.

z.Ruzhdi Shehu, sa i përket ndriçimit, është ne mirëmbajtje e sipër, e dimë se gjendja nuk është e mirë edhe cilësia e poçeve është e dobët por ne jemi ne proces te mirëmbajtjes dhe qe te funksionoj ne tersi ndriçimi publik duhet te bëjmë një projekt te ri dhe ta funksionalizojmë atë projekt. Ndërsa sa i përket rrugës "Jasiq-Gjocaj" është përgjegjësi e punë kryesit dhe projekti ende nuk ka përfunduar, është përgjegjësi edhe e ministrisë dhe duhet ta dini se ajo rrugë është rrugë per bjeshke dhe prap do te ketë këso dëmesh deri sa ta beje vendin e vet siç është rruga për Koshare per Rugove, këto janë te pritshme por duhet te sanohen.

z.Leonard Llolluni, po dua te di se cila drejtori e mbikëqyrë ketë projektin e riasfaltimit te rrugës Bajraktar-Shalaj-Gaxherr, dhe po dua te ngriti si çështje, afër rrugës se shtëpisë time është hapur një kanal dhe e kanë lenë te hapur, asfaltimi është kryer a atë kanal e kane lanë te hapur.

z.Zenun Shala, ai kanal nuk ka përfunduar ende asfaltimi ka përfunduar por aty do te intervenohet me beton.

znj.Erleta Qestaj, çështja ka te beje me ndriçimin publik ne lagjen "Moronicë" sa filloj te funksionoj prap është ndalur se funksionuari po dua te di se si qëndron çështja.

z.Ruzhdi Shehu, ndriçimi publik ende është ne mirëmbajtje dhe ende nuk ka përfunduar.

z.Shpejtim Gacaferi, pyetje tjetra nuk ka e shpalli te mbyllur mbledhjen e Majit-2023

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

_______________

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

_______________

03-180-5903
28
20.06.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

# RAPORT:

## Organizimi i Zgjedhjeve të Këshillave Lokale 2023 - Komuna e Junikut

*Hartuar nga:*
**Leonora Shehu** - Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë
Kryesuese e Komisionit për Zgjedhjet e Këshillave Lokale

*Junik, Qershor 2023*

## Përmbledhje Ekzekutive

Në mënyrë që komunat t'i realizojnë funksionet dhe përgjegjësitë e tyre të rregulluara sipas legjislacionit në fuqi (Ligjit për Vetëqeverisje Lokale) duhet të mbështesin themelimin dhe konsolidimin e Këshillave Lokale, të cilat përfaqësojnë fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Pra, Këshillat Lokal janë trupa të zgjedhura që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane.

Rregullorja (Shih shtojcën 1) për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Junikut, ka për qëllim të rregulloj organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane ne territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, te parashikuara ne Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis Komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, duke formuar këshilla lokale, si trupa mbështetës të Komunës dhe që të ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetareve ne procesin vendimmarrjes.

Për të reflektuar në këtë drejtim, Kuvendi i Komunës ka emëruar komisionin për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjidhjen e këshillave lokalë, dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Bazuar në Vendimin Nr. 02/04//2023 (Shih shtojca 2) për formimin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale në Komunës e Junikut, është emëruar Komisioni me këtë përbërje:

## Përbërja e komisionit:

1. Leonora Shehu – Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë
2. Shpejtim Gacaferi LDK- Kryesues i Kuvendit Komunal
3. Sadri Krasniqi LDK – anëtarë i Kuvendit
4. Zenel Maloku AAK – anëtarë i Kuvendit
5. Xhemë Tofaj LVV – anëtarë i Kuvendit
6. Safete Shehu – OJQ "Qershiza"
7. Anëtari i shtatë – zgjidhet një përfaqësues nga lokaliteti ku realizohen zgjedhjet sipas Rregullores.

## *Tabela e përmbajtjes:*


**1.0** - Procesi Parazgjedhor ........................................................................................

1.1 Komunikimi dhe Informimi ........................................................................................ 1

**2.0** – Zgjedhjet dhe mbarëvajtja e procesit zgjedhor ........................................................ 2

**3.0** - Këshillat Lokal ........................................................................................ 2

**4.0** - Këshilli Lokal Gjocaj dhe Jasiq ........................................................................ 3

4.1 -Të dhëna për pjesëmarrësit: ........................................................................ 4

4.2 -Përshkrimi i procesit zgjedhor: ........................................................................ 4

4.3 -Kryesia e Këshillit Lokal: ........................................................................ 4

**5.0** – Këshilli Lokal Krasniq, Miroc-Malok, Gaxherr dhe Shala: ........................................ 5

5.1 -Të dhëna për pjesëmarrësit: ........................................................................ 6

5.2 – Përshkrimi i procesit zgjedhor: ........................................................................ 6

5.3 – Kryesia e Këshillit Lokal: ........................................................................ 6

**6.0** – Këshilli Lokal Berishë, Goqaj dhe Qestaj: ........................................................ 7

6.1 – Të dhëna për pjesëmarrsit: ........................................................................ 8

6.2 – Përshkrimi i procesit zgjedhor: ........................................................................ 8

6.3 – Kryesia e Këshillit Lokal: ........................................................................ 8

**7.0** – Këshilli Lokal Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar: ........................................ 9

7.1 – Të dhëna për pjesëmarrësit: ........................................................................ 10

7.2 – Përshkrimi i procesit zgjedhor: ........................................................................ 10

7.3 – Kryesia e Këshillit Lokal: ........................................................................ 10

........................................................................ 11

## 1.0 - Procesi Parazgjedhor:

Komisioni ka mbajtur takime të rregullta, ku në takimin e parë të mbajtur me datë 03.03.2023 Komisioni ka zgjedhur Kryesuesen e Komisionit, ku sipas procedurës janë propozuar kandidatë për Kryesues, ku me pas me shumicë votash Komisioni ka vendosur që si Kryesuese të zgjidhet Leonora Shehu.

Në këtë takim u pëcaktuan fshatrat dhe lagjet e Komunës së Junikut në Katër Këshilla Lokal.

Pasi me Udhëzim Administrativ është pëcaktuar që Komuna e Junikut të ketë 4 Këshilla lokale, të gjithë anëtarët, u pajtuan që ndarja e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në 4 Këshilla lokale të përcaktohet në atë mënyrë që lagjet që janë afër, të caktohen në një Këshill lokal.

Me dakordimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit, përcaktimi fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, u bë në këta Këshilla lokale:

1) Këshilli lokal i fshatrave Gjocaj dhe Jasiq;
2) Këshilli lokal i lagjeve urbane Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar;
3) Këshilli lokal i lagjeve urbane Krasniq, Miroc, Gaxherr dhe Shala;
4) Këshilli lokal i lagjeve urbane Berishë, Goqaj, Qestaj.

Kryesuesja ka filluar menjëherë të punojë për procesin zgjedhor, ka propozuar disa formular të cilët do jenë funksional gjatë zgjedhjeve.

Në takimin pasues, Komisioni është pajtuar që të përdoren formularët të cilët Kryesuesja ju ka prezantuar secilit anëtar të Komisionit.

Poashtu, në këtë takim të Komisionit është hartuar orari i takimeve në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku do të zhvillohen zgjedhjet.

Si pikë e rendit të ditës në këtë takim ishte edhe caktimi i detyrave të anëtarëve të Komisonit, ku çdo anëtar shprehi gatishmërinë për ndihmë gjatë këtij procesi.

### 1.1 - Komunikimi dhe Informimi:

Gjatë procesit parazgjedhor, Kryesuesja ka propozuar Komisionit formularët të cilët do përdoren për punë gjatë procesit zgjedhor, të gjithë formularët që janë punuar nga Drejtoria për Administratë, janë shqyrtuar dhe aprovuar nga Komisioni. Këto janë:

1. Formular i lajmërimit/njoftimit të zgjedhjeve për Këshillin lokal (Shih shtojcën 3)
2. Formular i Orarit të mbajtjes së zgjedhjeve të Këshillave Lokale (Shih shtojcën 3)
3. Fleta për votimin e Kandidatit për Kryetar dhe Kryesisë (Shih shtojcën 4)
4. Formular i evidentimit të votuesve - Lista e pjesëmarrësve në Zgjedhjet e Këshillave Lokale 2023 (Shih shtojcën 5)

## 2.0 - Zgjedhjet dhe mbarëvajtja e procesit zgjedhor:

Procesi zgjedhor për Këshillat Lokale ka filluar sipas Rregullores dhe planifikimit të orarit të hartuar nga Komisioni në takimet paraprake.

Zgjedhjet kanë filluar me datë 22 maj 2023 dhe kanë përfunduar me datë 26 maj 2023. Gjatë kësaj periudhe zgjedhore janë realizuar gjithsejte 4 takime zgjedhore në 4 këshilla lokale.

Lidhur me zgjedhjet e Këshillit Lokal Gjocaj dhe Jasiq, Komisioni për ankesa i formuar nga Kuvendi i Komunës, me datë 24.05.2023 ka pranuar ankesë. Dhe pas shqyrtimit ka vendosur që të zëvendësoj një anëtar të zgjedhur pasi i njëjti mban pozitë udhëheqëse të subjektit politik në nëndegën Jasiq. Komisioni ka vendosur që kandidati të zëvendësohet me kandidatin tjetër që është në listë të pritjes në bazë të numrit të votave. Kurse, sa i përket Këshillave të tjerë nuk ka pasur ndonjë ankesë.

Në zgjedhjet për Këshilla Lokale të mbajtura me 22 Maj 2023, prezent ishin edhe vëzhguesit e organizatëss ndërkombëtare OSCE.

Në proces të votimit kanë marrë pjesë **479** votues.

- Nga gjithsejtë 479 pjesëmarrës të nënshkruar në lista të votimit, nga ta **meshkuj 445** dhe **femra 34** .
- Janë zgjedhur 4 Kryetar të Këshillave Lokale, dhe 18 anëtar të kryesive të këshillave për çdo këshill, nga ta **meshkuj 14 ndërsa femra 4**, ku zgjedhja është bërë sipas përcaktimit të secilit Këshill për numrin nga (5-7-9), dhe sipas kandidimit vërtetohet se çdo kandidat ka pas kundër kandidat për një vend ne këshill.

Me tutje, do paraqesim një raport të hollësishëm me të dhënat sipas secilit Këshill Zgjedhor:

## 3.0 - Këshillat Lokal :

1. Këshilli Lokal "Gjoçaj dhe Jasiq"

2. Këshilli Lokal "Krasniq, Miroc-Malok, Gaxherr dhe Shala"

3. Këshilli Lokal "Berishë, Goqaj dhe Qestaj"

4. Keshilli Lokal "Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar.

## 4.0 - Këshilli Lokal Gjocaj dhe Jasiq:

**Data e mbajtjes se zgjedhjeve:** **22.05.2023**

### 4.1 - Të dhëna për pjesëmarrësit:

Te dhënat për pjesëmarrësit, gjinia, kryetari dhe anëtarët e kryesisë

| | |
|---|---|
| Numri total i pjesëmarrësve: | 41 |
| Pjesëmarrës meshkuj: | 40 |
| Pjesëmarrëse femra: | 1 |
| Kandidat të propozuar: | 7 |
| Kryesia e përbërë nga anëtar: | 5 |
| Anëtarë meshkuj në Kryesi: | 4 |
| Anëtare femra në Kryesi: | 1 |

### 4.2 - Përshkrimi i procesit Zgjedhor

Në fillim të procesit është bërë hapja e takimit zgjedhor nga kryesuesja e komisionit Leonora Shehu, më pas është bërë prezantimi i komisionit dhe rregullave të procesit zgjedhor për pjesëmarrësit, proces i cili bazohet në Rregulloren Komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut. Pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe anëtarët e organizatës OSCE. Është zgjedhur anëtari i shtatë nga banorët e këshillit, u zgjodh me votën e shumicës së pjesëmarrësve prezent. Pjesëmarrësit pas propozimit për 5-7-9 anëtarë në kryesi të këshillit, kanë vendosur që kryesia e këshillit të përbëhet nga 5 anëtarë, më pas është bërë thirrja për propozimet e kandidaturës. Pasi janë propozuar kandidatët, është zhvilluar procesi i votimit. Pasi ka përfunduar procesi i votimit,

nga komisioni është bërë numërimi i votave nga kutitë e votimit. Është zgjedhur kryesia ne përbërje prej 5 anëtarëve, 4 meshkuj dhe 1 femër.

### 4.3 - Kryesia e Këshillit lokal:

Te dhënat ne formë tabelore për kryetarin dhe kryesinë e këshillit lokal – Gjocaj dhe Jasiq.

| Nr. | Emri | Mbiemri | Pozita | Lokacioni |
| --- | --- | --- | --- | --- |
| 1 | Arif | Maloku | Kryetar | Gjocaj dhe Jasiq |
| 2 | Qamil | Jasiqi | Anëtar | Gjocaj dhe Jasiq |
| 3 | Zize | Gjocaj | Anëtar | Gjocaj dhe Jasiq |
| [illegible] | Xhemë | Ganijaj | Anëtare | Gjocaj dhe Jasiq |
| 5 | Demë | Gjocaj | Anëtar | Gjocaj dhe Jasiq |

Në Këshillin lokal Gjocaj dhe Jasiq, votimi përfundoi pa asnjë problem të evidentuar.

## 5.0 - Këshilli Lokal Krasniq, Miroc-Malok, Gaxherr dhe Shala:

**Data e mbajtjes se zgjedhjeve:** **24.05.2023**

### 5.1 - Të dhëna për pjesëmarrësit:

Te dhënat për pjesëmarrësit, gjinia, kryetari dhe anëtarët e kryesisë

| | |
|---|---|
| Numri total i pjesëmarrësve: | 145 |
| Pjesëmarrës meshkuj: | 138 |
| Pjesëmarrëse femra: | 7 |
| Kandidat të propozuar: | 10 |
| Kryesia e përbërë nga anëtar: | 5 |
| Anëtarë meshkuj në Kryesi: | 4 |
| Anëtare femra në Kryesi: | 1 |

### 5.2 - Përshkrimi i procesit Zgjedhor

Në fillim të procesit është bërë hapja e takimit zgjedhor nga kryesuesja e komisionit Leonora Shehu, më pas është bërë prezantimi i komisionit dhe rregullave të procesit zgjedhor për pjesëmarrësit, proces i cili bazohet në Rregulloren Komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut. Është zgjedhur anëtari i shtatë nga banorët e këshillit, u zgjodh me votën e shumicës së pjesëmarrësve prezent. Pjesëmarrësit pas propozimit për 5-7-9 anëtarë në kryesi të këshillit, kanë vendosur që kryesia e këshillit të përbëhet nga 5 anëtarë, më pas është bërë thirrja për propozimet e kandidaturës. Pasi janë propozuar kandidatët, është zhvilluar procesi i votimit. Pasi ka përfunduar procesi i votimit, nga komisioni është bërë numërimi i votave nga kutitë e votimit. Është zgjedhur kryesia ne përbërje prej 5 anëtarëve, 4 meshkuj dhe 1 femër.

**5.3 - Kryesia e Këshillit lokal:**

Te dhënat ne formë tabelore për kryetarin dhe kryesinë e Këshillit lokal Krasniq, Miroc-Malok, Gaxherr dhe Shala.

| Nr. | Emri | Mbiemri | Pozita | Lokacioni |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Myrtë | Shala | Kryetar | Krasniq,Miroc-Malok, Gaxherr dhe Shala |
| 2 | Asllan | Krasniqi | Anëtar | Krasniq,Miroc-Malok, Gaxherr dhe Shala. |
| 3 | Bujar | Maloku | Anëtar | Krasniq,Miroc-Malok, Gaxherr dhe Shala |
| 4 | Ahmet | Krasniqi | Anëtare | Krasniq,Miroc-Malok, Gaxherr dhe Shala |
| 5 | Ariola | Krasniqi | Anëtar | Krasniq,Miroc-Malok, Gaxherr dhe Shala |

Në Këshillin lokal Krasniq, Miroc-Malok, Gaxherr dhe Shala, votimi përfundoi pa asnjë problem të evidentuar.

## 6.0 - Këshilli Lokal Berishë, Goqaj dhe Qestaj:

**Data e mbajtjes se zgjedhjeve: 25.05.2023**

### 6.1 - Të dhëna për pjesëmarrësit:

Te dhënat për pjesëmarrësit, gjinia, kryetari dhe anëtarët e kryesisë

| | |
|---|---|
| Numri total i pjesëmarrësve: | 105 |
| Pjesëmarrës meshkuj: | 100 |
| Pjesëmarrëse femra: | 5 |
| Kandidat të propozuar: | 9 |
| Kryesia e përbërë nga anëtar: | 5 |
| Anëtarë meshkuj në Kryesi: | 4 |
| Anëtare femra në Kryesi: | 0 |

### 6.2 - Përshkrimi i procesit Zgjedhor

Në fillim të procesit është bërë hapja e takimit zgjedhor nga kryesuesja e komisionit Leonora Shehu, më pas është bërë prezantimi i komisionit dhe rregullave të procesit zgjedhor për pjesëmarrësit, proces i cili bazohet në Rregulloren Komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut. Është zgjedhur anëtari i shtatë nga banorët e këshillit, u zgjodh me votën e shumicës së pjesëmarrësve prezent. Pjesëmarrësit pas propozimit për 5-7-9 anëtarë në kryesi të këshillit, kanë vendosur që kryesia e këshillit të përbëhet nga 5 anëtarë, më pas është bërë thirrja për propozimet e kandidaturës. Pasi janë propozuar kandidatët, është zhvilluar procesi i votimit. Pasi ka përfunduar procesi i votimit, nga komisioni është bërë numërimi i votave nga kutitë e votimit. Është zgjedhur kryesia ne përbërje prej 5 anëtarëve.

### 6.3 - Kryesia e Këshillit lokal:

Te dhënat ne formë tabelore për kryetarin dhe kryesinë e Këshillit lokal Berishë, Goqaj dhe Qestaj.

| Nr. | Emri | Mbiemri | Pozita | Lokacioni |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Burim | Kuqi | Kryetar | Berishë,Goqaj dhe Qestaj |
| 2 | Zenel | Salihaj | Anëtar | Berishë,Goqaj dhe Qestaj |
| 3 | Neki | Goqi | Anëtar | Berishë,Goqaj dhe Qestaj |
| 4 | Haxhë | Qestaj | Anëtar | Berishë,Goqaj dhe Qestaj |
| 5 | Armend | Metaj | Anëtar | Berishë,Goqaj dhe Qestaj |

Në Këshillin lokal Berishë, Goqaj dhe Qestaj, votimi përfundoi pa asnjë problem të evidentuar

## 7.0 - Këshilli Lokal Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar:

**Data e mbajtjes së zgjedhjeve:** **26.05.2023**

### 7.1 - Të dhëna për pjesëmarrësit:

7.2

Te dhënat për pjesëmarrësit, gjinia, kryetari dhe anëtarët e kryesisë

| | |
|---|---|
| Numri total i pjesëmarrësve: | 188 |
| Pjesëmarrës meshkuj: | 167 |
| Pjesëmarrëse femra: | 21 |
| Kandidat të propozuar: | 12 |
| Kryesia e përbërë nga anëtar: | 7 |
| Anëtarë meshkuj në Kryesi: | 5 |
| Anëtare femra në Kryesi: | 2 |

### 7.2 - Përshkrimi i procesit Zgjedhor

Në fillim të procesit është bërë hapja e takimit zgjedhor nga kryesuesja e komisionit Leonora Shehu, më pas është bërë prezantimi i komisionit dhe rregullave të procesit zgjedhor për pjesëmarrësit, proces i cili bazohet në Rregulloren Komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut. Është zgjedhur anëtari i shtatë nga banorët e këshillit, u zgjodh me votën e shumicës së pjesëmarrësve prezent. Pjesëmarrësit pas propozimit për 5-7-9 anëtarë në kryesi të këshillit, kanë vendosur që kryesia e këshillit të përbëhet nga 7 anëtarë, më pas është bërë thirrja për propozimet e kandidaturës. Pasi janë propozuar kandidatët, është zhvilluar procesi i votimit. Pasi ka përfunduar procesi i votimit, nga komisioni është bërë numërimi i votave nga kutitë e votimit. Është zgjedhur kryesia ne përbërje prej 7 anëtarëve, 5 meshkuj dhe 2 femra.

**7.3 - Kryesia e Këshillit lokal:**

Te dhënat ne formë tabelore për kryetarin dhe kryesinë e Këshillit lokal Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar.

| Nr. | Emri | Mbiemri | Pozita | Lokacioni |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mirlind | Gacaferi | Kryetar | Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar. |
| 2 | Muharrem | Shehu | Anëtar | Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar. |
| 3 | Petrit | Gacaferi | Anëtar | Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar. |
| 4 | Miftar | Gjota | Anëtar | Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar. |
| 5 | Dukagjin | Llolluni | Anëtar | Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar. |
| 6 | Shqipdona | Shehu | Anëtare | Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar. |
| 7 | Riola | Gacaferi | Anëtare | Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar. |

Në Këshillin lokal Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar, votimi përfundoi pa asnjë problem të evidentuar.

## Rekomandimet nga komisioni:

- Hartimi i planit të punës së këshillave të lagjeve dhe fshatrave ;
- Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e këshillit të gjithë anëtarët e këshillit;
- Këshillat lokal të rrisin bashkëpunimin me organizatat lokale dhe ndërkombëtare të cilat kanë për qëllim fuqizimin e tyre dhe ngritjen e kapaciteteve të këshillave;
- Të rritet komunikimi dhe bashkëpunimi në mes të këshillave;
- Të përgatiten të gjitha dokumentacionet e kërkuara me Rregullore gjatë takimove të këshillave, duke përfshi agjendat dhe procesverbalet.
- Të rritet variabiliteti i këshillave dhe promovimi i aktiviteteve të tyre;
- Të rritet pjesëmarrja e gjinisë femërore në zgjedhjen e Këshillave.

## Faleminderit:

Një falënderim të veçantë për komisionit e përzgjedhur nga kuvendi i komunës së Junikut, i cili i përbërë nga ekzekutivi, partitë politike dhe shoqëria civile, komision ky që kishte rol kyç në organizimin, mbarëvajtjen dhe në ruajtjen e secilës votë të secilit qytetarë të Komunës së Junikut, duke siguruar zgjedhje të lira, vota të lira dhe demokratike në secilën këshill lokal të komunës së Junikut.

**Shënim**

Të gjitha të dhënat e prezantuar në raport janë të vërtetuara dhe të dokumentuara, dhe me përgjegjësi të plotë nga komisioni i cili kishte për mandat organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve, andaj si i tillë është i aprovuar nga secili anëtarë i komisionit:

1. Leonora Shehu- Drejtoreshë e Administratës
2. Shpejtim Gacaferi Kryesues i Kuvendit
3. Sadri Krasniqi - LDK
4. Zenel Maloku - AAK
5. Safete Shehu - OJQ "Qershiza"

*Shtojcë 1 : Rregullore për Këshillat Lokale*

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

# RREGULLORE
# PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË JUNIKUT

**Junik, Janar 2023**

https://kk.rks-gov.net/junik

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2. pika c) dhe nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale , Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave më Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Nenit 13-15 të Statutit të Komunës së Junikut, 001//3127, të dt.30.09.2010, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.01.2023, miratoi këtë:

# RR E G U LL O R E
# PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË JUNIKUT

## Neni 1
## Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, të përcaktuara në bazë të ligjit për vetëqeverisjen lokale.

## Neni 2
## Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane duke formuar këshillat lokale si trupa mbështetës të organeve të komunës, dhe që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimarrjes.

## Neni 3
## Formimi i komisionit nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale

1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtar, katër (4) nga Kuvendi i Komunës, një (1) nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) nga pëfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ndërsa përfaqësuesi (1) nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal, zgjedhet në mënyrë ad-hoc nga Komisioni.

2. Komisioni duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor dhe etnik. Nga shtatë (7) anëtarët e komisionit tre (3) duhet të jenë femra.

3. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e komisonit. Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës

4. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve të qytetarëve, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

5. Së paku katër (4) anëtar të Komisionit, duhet të jenë të pranishëm në të gjitha takimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokale.

6. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.

7. Komisioni i raporton Kuvendit të Komunës për procesin e përzgjedhjes së këshillave lokale.

8. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:

8.1 shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet ku do të zgjedhen këshillat lokale;
8.2. mediave lokale;
8.3. web – faqes zyrtare të komunës.

9. Njoftimi i publikut domosdo duhet të përmbajë: rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së tubimit

**Neni 4**
**Komisioni i ankesave**

1. Kuvendi i Komunës themelon Komisionin e ankesave, i cili i shqyrtojn ankesat lidhur me procesin e zgjedhjeve të këshillave lokale.

2. Komisoni i ankesave do të përbëhet prej tre anëtarëve që zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësoj përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.

3. Te gjithë pjesëmarrësit në takimin zgjedhor mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë procesit zgjedhor.

4. Ankesat për shkelje apo parregullsi në procesin zgjedhor duhet të paraqiten pranë Komisionit për ankesa, brenda 3 (tri) ditëve të punës.

5. Komisioni i ankesave është i obliguar që ti shqyrtoj të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e pranimit të kërkesës, t'u kthejë përgjigje me shkrim atyre personave që kanë parashtruar ankesë. Vendimet e Komisionit të ankesave i përcjellen Kryesuesit të Komisionit për zgjedhjen e Këshillave lokale menjëherë pas marrjes së tyre.

6. Vendimet e Komisonit të ankesave janë obligative.

7. Komisioni i ankesave i raporton Kuvendit të Komunës.

## Neni 5
## Formimi i këshillave lokale dhe kriteret e përzgjedhjes

1. Këshilli lokal mund të ketë nga pesë (5) deri në nëntë (9) anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill lokal përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.

2. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal. Në rast kur këshilli lokal ka numër çift të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, atëherë fshati, vendbanimi ose lagjja urbane me numër më të madh të banorëve përfaqësohet me dy anëtar në këshillin lokal.

3. Përbërja e këshillave lokale të fshatit duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të përfshijë minimum 30%. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane, jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal.

4. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë në tubimin e qytetarëve.

5. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë qytetarë të përhershëm në atë lokalitet.

6. Kandidatët për anëtarë apo kryetarëve të këshillit lokal, nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur apo emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve politike.

7. Anëtar të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, zgjidhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.

8. Kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, kandidati i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim.

9. Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo më shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë mbahet rrethi i dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për anëtar dhe kryetar të këshillit lokal.

10. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç të atij lokaliteti. Çdo fshat, vendbanim apo lagje duhet të propozojë së paku dy kandidatë për përfaqësim në këshillin lokal.

11. Takimet kanë legjitimitet juridik, nëse të pranishëm janë së paku 20 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti, duke respektuar kuotën gjinore.

12. Mandati i këshillave lokale është katër (4) vite.

**Neni 6**
**Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale**

1. Në rastet kur qytetarët konsiderojnë që anëtarët ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushë obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtarët dhe kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicë të votave të banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane me rastin e tubimit publik me qytetarë.

2. Në mënyrë që të bëhet ky votim, kërkohet një peticion për ndërprerjen e mandatit që duhet të nënshkruhet nga banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ky peticion duhet të mbledh nënshkrimet e më shume se gjysma e numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur këshilli lokal. Komuna duhet të lajmërohet paraprakisht për një mbledhje të tillë.
3. Në rastet kur këshilli lokal shkarkohet sipas procedurave në paragrafin 2, një votim i ri duhet menjëherë të bëhet në bazë të procedurave të nenit 5 të kësaj rregulloreje në mënyrë që të zgjedhet një këshill i ri lokal. Rezultatet e votimit duhet të raportohen në bazë të kërkesave të nenit 6 të kësaj rregulloreje.
4. Mandati i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon:

4.1 me kryerje të mandatit,
4.2 nëse vdes,
4.3 nëse jep dorëheqje,
4.4 nëse ndërron vendbanim,
4.5 nëse shkarkohet,
4.6 nëse kryen vepër penale.

**Neni 7**
**Procesverbali nga tubimi zgjedhor**

1. Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përshkruajë; numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.

2. Procesverbalin e nënshkruan kryesnesi i tubimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve, për zgjedhjen e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

3. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve, kryetarit të këshillit lokal duhet të bëhen publike menjëherë pas tubimit zgjedhor.

## Neni 8
## Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokal

1. Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet e rregullta publike, takimet për planifikim strategjik që organizohen nga komuna përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.

2. Së paku një anëtar i këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet të jetë i përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për planifikim të planeve urbane, zhvillimore dhe rurale që janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.

3. Kryetari i Komunës duhet që së paku të organizojë dy takime në vit me udhëheqësit e këshillave lokale. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj. Për rendin e ditës duhet të konsultohen edhe udhëheqësit e këshillave lokale.

4. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

## Neni 9
## Bartja e aktiviteteve nga komuna te këshillat lokale

1.Me kërkesën e këshillit lokal dhe rekomandimin e Kryetarit të Komunës apo ndonjë komiteti të komunës, Kuvendi i Komunës me vendim mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokale të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane. Aktivitetet që mund të transferohen duhet të jenë në kompetencë ekskluzive vetanake të komunës.
2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal.

3. Në rast të bartjes se aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal, komuna ofron mbështetje dhe burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartur.

## Neni 10
## Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet në interes të lokalitetit si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.

2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit, në të gjitha sferat në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale.

3. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet të informojë komunën për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.

4. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

5 . Këshilli lokal mund të ndërmarë aktivitetet të cilat në veçanti ndikojnë në:

5.1. zhvillimin lokal ekonomik të qëndrueshëm të lokalitetit;
5.2. planifikimin urban dhe rural të lokalitetit;
5.3. mbrojtjen e mjedisit lokal të lokalitetit;
5.4. ndihmon në rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda lokalitetit;
5.5. siguron te dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime, propozime për mbështetje të këtyre rasteve;
5.6. mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave publike të gjelbëruara;
5.7. zhvillimin e turizmit;
5.8. organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
5.9. bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizata të tjera të shoqërise civile për çështjet me interes për lokalitetin;
5.10. organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin;
5.11. zbaton aktivitetet që janë të bartura, sipas procedurave në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

6. Këshillat lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës përkatëse.

7. Këshillat lokale mund t'i parashtrojnë organeve të kuvendit, pyetje me shkrim për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, kurse organet e komunës brenda afatit 30 ditësh i përgjigjen këshillit lokal.

**Neni 11**
**Roli i kryetarëve të këshillave lokale**

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e komunës.

2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq me mbledhjet e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit lokal. Poashtu, ai i nënshkruan konkluzionet dhe propozimet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditëve, nga dita e miratimit të tyre, t'i dorëzojë te Kryetari i Komunës.

### Neni 12
### Financimi i aktiviteteve

Aktivitetet e këshillave lokale dhe projektet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mes komunës dhe këshillave lokale mund të financohen si vijon:
Nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane;
Nga komuna;
Nga donatorët; dhe
Me financim të përbashkët.

### Neni 13
### Kompenzimi i këshillave lokale

Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompenzohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
Kompenzimi për kryetarët e këshillave lokale bëhet në vlerën financiare ekuivalente me anëtarët e komiteteve obligative.
Kompenzimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.

### Neni 14
### Mospërmbushja e përgjegjësive

Për të gjitha aktivitetet e bartura në këshillin lokal nga Kuvendi i Komunës, këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane përkatëse mban obligime dhe përgjegjësi ligjore.

### Neni 15
### Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare

Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregullore me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) 02/2010 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane apo me Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e Ligjit, Udhëzimit Administrativ dhe Statutit.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e këshillave lokale të Komunës së Junikut, të datës 05.11.2015.

**Neni 16**

1. Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje janë Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Administratë.

2. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njejtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

**Neni 17**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ueb-faqen e Komunës.

**Datë: 27.01.2023**

**Junik**

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Shpejtim Gacaferi**

*Shtojcë 2: Vendimi për themelimin e Komisionit*

02-180-833
1
30.01.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT - OPSTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/04/23;**
**Date: 27.01.2023**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 te Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.01.2023 nxjerrë:

**VENDIM**

**për formimin e Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Junikut**

**I.** Me këtë vendim formohet Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Junikut.

**II.** Komisionin e përbejnë 7 anetarë . Kater nga radhet e kuvendit një nga radhet e ekzekutivit dhe një nga shoqëria civile (OJQ-të).

1. **Nga radhet e kuvendit:** Sadri Krasniqi,
   Zenel Maloku,
   Xhemë Tofaj,
   Shpëjtim Gacaferi,
2. **Nga ana e ekzekutivit:** Leonora Shehu - Drejtoreshë e Administrates,
3. **Nga shoqërija civile:** Safete Shehu – OJQ- Qershiza.
4. **Një nga ana e secilës bashkesi lokale, apo fshat.**

**III.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:
1. MAPL ;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Të apostrofuarit në pikën II;
4. Sherbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim GACAFERI

Kryesues

Adresa
Tel.: +383 (0) 44 ...
http://kk-gov.net/junik

03-180-3371
25.05.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

# NJOFTIM

Të nderuar qytetarë,

Komuna e Junikut, respektivisht Komisoni për zgjedhjen e Këshillave Lokale do të filloj me procesin e zgjedhjes së Këshillave Lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Ju ftojmë që të merrni pjesë në këto takime të cilat do të organizohen në datat e mëposhtme:

## Orari i takimeve

| Nr. rendor | Emri i Këshillit Lokal | Data e mbajtjes | Ora | Vendi i mbajtjes së takimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Këshilli Lokal i fshatrave: Gjocaj dhe Jasiq | 22 Maj 2022 | 19:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 2 | Këshilli Lokal i lagjeve urbane: Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar | 23 Maj 2023 | 19:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 3 | Këshilli Lokal i lagjeve urbane: Krasniq, Miroc, Gaxherr dhe Shala | 24 Maj 2023 | 19:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 4 | Këshilli Lokal i lagjeve urbane: Berishë, Goqaj dhe Qestaj | 25 Maj 2023 | 19:00 | Salla e Kuvendit Komunal |

**Rendi i ditës:**
1) Zgjedhja e Këshillit Lokal,
2) Zgjedhja e Kryetarit/es të Këshillit Lokal,
3) Të ndryshme.

Kryesuese e Komisionit
Leonora Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

ZGJEDHJET PËR KËSHILLA LOKALE NË KOMUNËN E JUNIKUT

Fletëvotim për anëtarë të Këshillit

| Nr. rendor | Emri dhe mbiemri i kandidatit/es | Vota me √ ose X |
|---|---|---|
| 1 | | ☐ |
| 2 | | ☐ |
| 3 | | ☐ |
| 4 | | ☐ |
| 5 | | ☐ |
| 6 | | ☐ |
| 7 | | ☐ |
| 8 | | ☐ |
| 9 | | ☐ |
| 10 | | ☐ |
| 11 | | ☐ |
| 12 | | ☐ |

Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Lista e pjesëmarrësve në zgjedhjet e Këshillave Lokale, 2023

KESHILLI LOKAL I LAGJEVE GACAGER, QENDËR, PEPSH DHE BAJRAKTAR

| Nr. rendor | Emri dhe mbiemri | Vendbanimi/fshati/lagjja urbane | Mosha | Numri personal | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |
| 6 | | | | | |
| 7 | | | | | |
| 8 | | | | | |
| 9 | | | | | |
| 10 | | | | | |
| 11 | | | | | |
| 12 | | | | | |
| 13 | | | | | |
| 14 | | | | | |
| 15 | | | | | |
| 16 | | | | | |
| 17 | | | | | |
| 18 | | | | | |
| 19 | | | | | |
| 20 | | | | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 20.06.2023 |
| PËR/ZA/TO: | z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal, Junik |
| CC: | z.Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës, Junik |
| NGA/OD/FROM: | Leonora Shehu - Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme, Kryesuese e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale |
| TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT: | Kërkesë |

I nderuar,

Komisioni për zgjedhjen e Këshillave Lokale, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Junikut Nr. 001/3127, të datës 29.09.2010, dhe Udhëzimit Administrativ 02/2019 për oganizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, kërkojmë që të vendosni në rendin e ditës Raportin e organizimit të zgjedhjeve të Këshillave Lokale në Komunën e Junikut.

Të bashkëngjitur gjeni Raportin.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 02-180-5249
Nr. i Faq. 27
Data 14/06/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 14.06.2023 |
| PËR/ZA/TO: | z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal |
| CC: | z.Ruzhdi Shehu– Kryetar i Komunës |
| NGA/OD/FROM: | z.Demokrat Ganijaj – Drejtor për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë |

I nderuar,

Bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Junikut Nr. 02/13 të datës 28.02.2023, Nr. Prot. 2-180/1805, për themelimin e komisionit për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, kërkojmë që të futet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës në KPF dhe në Kuvendin Komunal, miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut. Pas miratimit të leximit të parë nga Kuvendi Komunal dhe diskutimit publik, komisioni ka pranuar kërkesat nga DSHPIMSH, për plotësim ndryshim të rregullores për lexim të dytë, të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar si në vijim:

| Nr. | **Leximi i I (parë) i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut** | **Leximi i II (dytë) Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut** |
|---|---|---|
| 1. | Neni 23<br>Zyret e partive politike dhe serviste të ndryshme (elektronike dhe TI), kanë qenë në nënkategorinë e dytë. | Neni 23<br>Zyret e partive politike dhe serviste të ndryshme (elektronike dhe TI), kalojnë në nënkategorinë e parë. |
| 2. | Neni 23<br>Byrektoret kanë qenë të parapara në nënkategorinë e dytë. | Neni 23<br>Byrektoret përfshihen së bashku me furrat e bukës në nënkategorinë e tretë. Pra hiqen nga nënkategoria e dytë për të mos u përsëritur dy herë. |
| 3. | Neni 23<br>Bastoret kanë qenë të parapara nënkategorinë dytë. | Neni 23<br>Bastoret hiqen tërësisht, sepse janë të ndaluara me ligj. |
| 4. | Neni 23<br>Gjelltoret dhe qebaptoret kanë qenë në nënkategorinë e katërt. | Neni 23<br>Gjelltoret dhe qebaptoret kalojnë në nënkategorinë e tretë. |
| 5. | Neni 23<br>Çmimi për amvisëri ka qenë 6.50€. | Neni 23<br>Çmimi për amvisëri bëhet 6.00€. |

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Junikut
Opština Junik- Municipality of Junik

# RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E JUNIKUT

Junik, ___ Qeshor 2023

Kuvendi i Komunës së Junikut,
Në mbështetje të nenit 11, nenit 12.2 (c), dhe nenit 17 (f) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 15.7, nenit 34 (paragrafi 2 dhe paragrafi 7) dhe nenit 80 të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022), si dhe nenit 22.1 të Statutit të Komunës, të datës 29.09.2010, në mbledhjen e mbajtur më __ . __.20__ . miraton këtë:

# RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E JUNIKUT

## KAPITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e sistemit dhe standardet e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave, hartimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, krijimin e kushteve për zbatimin e tij si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organit kompetent komunal për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, në territorin e Komunës së Junikut, në mënyrë që të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis.

### Neni 2
### Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet:
   1.1. në territorin e Komunës së Junikut, për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, dhe

1.2. ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik, prodhuesve dhe zotëruesve të mbeturinave dhe operatorëve që merren me menaxhimin e mbeturinave në/dhe për territorin e Komunës së Junikut.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për kategoritë e mbeturinave të përjashtuara sipas Ligjit për mbeturina dhe ligjeve dhe akteve të veçanta.

**Neni 3**

**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
   1.1. **Administrata komunale** - të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal siç përkufizohet në Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 04 qershor 2008);
   1.2. **Deponi** - vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës;
   1.3. **Gazeta Zyrtare** – Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës;
   1.4. **Komunë** - Komuna e Junikut, njësi e vetëqeverisjes lokale, në territorin dhe me kufijtë administrativë të përcaktuar sipas Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave (Gazeta Zyrtare, nr. 26, 2 qershor 2008);
   1.5. **Konsumator** - personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime te caktuara sipas Ligjit për mbeturina dhe kësaj rregulloreje;
   1.6. **Kompostim** - është procesi i dekompozimit të kontrolluar të mbeturinave organike me qëllim të prodhimit të kompostit;
   1.7. **Kryetar** - Kryetari i Komunës së Junikut;
   1.8. **Kuvend** - Kuvendi i Komunës së Junikut;
   1.9. **Ligj/Ligji për mbeturina** - Ligji nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022);
   1.10. **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** - Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008),
   1.11. **Ligji për bashkëpunim ndërkomunal** - Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal (Gazeta Zyrtare, nr. 7, 10 gusht 2011);
   1.12. **Leje përkatëse mjedisore** - nënkupton Leje mjedisore ose Leje mjedisore e integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
   1.13. **Magazinim** - ruajtja e sigurt dhe e përkohshme e mbeturinave në objektet e parapara për këtë qëllim.

1.14. **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh;

1.15. **Menaxhimi i mbeturinave** - nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin, transportin, përpunimin-rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen e operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e mëvonshme të vendeve të depozitimit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;

1.16. **Mbeturina të rrezikshme** - nënkupton mbeturina që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme të listuara në Shtojcën 1 të Ligjit për mbeturina;

1.17. **Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme;

1.18. **Mbeturina të veçanta** - mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohen të veçanta sipas nenit 38.4. të Ligjit për mbeturina;

1.19. **Mbeturina inerte** - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

1.19.1. mbeturina inerte qe nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

1.19.2. i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;

1.20. **Mbeturinat komunale** - nënkupton:

1.20.1. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobiliet;

1.20.2. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturinat shtëpiake;

1.20.3. mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit.

1.21. **Mbeturina komerciale** - nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale dhe që nënkuptohet çdo mbeturinë e prodhuar nga

një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kanaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi;

1.22. **Mbeturina ushqimore** - nënkupton mbeturinat e çdo substance apo produkti, qofte i përpunuar, i përpunuar pjesërisht ose i papërpunuar, e që pritet të konsumohet nga njerëzit, pijet, çamçakëzët dhe çdo substance, përfshire edhe ujin, të përfshirë qëllimisht në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij.

1.23. **Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi** - nënkupton mbeturinat e krijuara nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjes;

1.24. **Mbeturina të vëllimshme** - nënkupton mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, mobiliet, dhe mbeturina tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave e pengojnë përdorimin e zakonshëm të grumbullimit, transportimit dhe largimit dhe kërkohet që kjo të bëhet në mënyrë të veçantë;

1.25. **Mbledhja** - mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave;

1.26. **Mbledhja e ndarë** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet ne mënyrë te ndare në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik;

1.27. **Ministria** - Ministria përkatëse për mjedisin;

1.28. **Operatori** - nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili është përzgjedhur nga organi kontraktues i Komunës për ofrimin e shërbimeve publike për menaxhimin e mbeturinave, brenda territorit të Komunës së Junikut, në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbeturina, Ligjit për prokurimin publik dhe legjislacionin përkatës në fuqi;

1.29. **Organe komunale** - nënkupton Kuvendin dhe Kryetarin e Komunës së Junikut;

1.30. **Person** - person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave;

1.31. **Prodhuesi i mbeturinës** - çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës;

1.32. **PKMM** - Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave;

1.33. **Qeveria** - Qeveria e Republikës së Kosovës;

1.34. **Riciklimi** - çdo operim te përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave;

1.35. **Statut** - Statuti i Komunës së Junikut, i datës 29.09.2010;

1.36. **Trajtimi i mbeturinave** - nënkupton të gjitha operacionet e përpunimit ose magazinimit, deponimit, përfshirë përgatitjet para përpunimit ose magazinimit, deponimit të mbeturinave;

1.37. **ZMM** - Zyrtari për Menaxhimin e Mbeturinave, që vepron në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili zbaton politikat në fushën e mbrojtjes përcaktuar nga ministritë përkatëse dhe legjislacioni përkatës në fuqi për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale;

1.38. **Zotëruesi i mbeturinës** - prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.

2. Termat tjerë të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për mbeturina, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Statutin.

## KAPITULLI II - SISTEMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

### Neni 4
### Parimet për menaxhimin e mbeturinave

1. Mbeturinat në Komunën e Junikut, mblidhen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbeturina, këtë rregullore, PKMM si dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi.

2. Menaxhimi i mbeturinave në territorin e Komunës së Junikut bëhet duke u bazuar në respektimin e parimeve dhe sipas kuptimeve të përcaktuara në Nenin 5 të Ligjit për mbeturina, si në vijim:

2.1. Parimi i afërsisë dhe vetë trajtimit;

2.2. Parimi i vigjilencës dhe parandalimit;

2.3. Parimi ku ndotësi paguan;

2.4. Parimi për menaxhimin e mbeturinave i sistemuar sipas prioriteteve;

2.5. Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit dhe zotëruesit;

2.6. Parimi i sigurimit financiar;

2.7. Parimi për qasje të publikut në informata;

2.8. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë.

## Neni 5
## Organizimi i menaxhimit të mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Junikut, duhet të organizohet në atë mënyrë që të:

1.1. mbulohet i tërë territorit të Komunës me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave dhe arritjen e shkallës 100% të grumbullimit dhe transportimit;

1.2. bëhet rritja e cilësisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë dhe ngritja e kapaciteteve institucionale të menaxhimit të mbeturinave;

1.3. rishikimi i procesit tarifor për të siguruar mekanizëm të qëndrueshëm të financimit;

1.4. përmirësim i performancës operative dhe financiare të ofruesve të shërbimit;

1.5. parandalimi dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave;

1.6. parandalohet ndotja nga mbeturinat dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh në mënyrë që të mënjanohet çdo dëm a rrezik për mjedisin dhe për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së njeriut;

1.7. ruhet fauna dhe flora, mjedisi e peizazhi nga degradimi, dhe sidomos të ruhen burimet natyrore nga ndikimet e mbeturinave;

1.8. sigurohen shërbime të rregullta dhe të besueshme drejt mbledhjes së mbeturinave dhe trajtimit të tyre të ndarë, në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbeturinat e rrezikshme;

1.9. përmirësohet qasja në shërbimet e menaxhimit të mbeturinave nga popullata në zonat urbane dhe rurale në përputhje me politikat qeveritare dhe PKMM;

1.10. zbatojnë shërbimet bazë të menaxhimit të mbeturinave drejt qëndrueshmërisë dhe mbeturinat t'i nënshtrohen sa më shumë reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit;

1.11. zhvillohet potenciali ekonomik i ekonomisë qarkore, me përfshirjen e grupeve të cenueshme;

1.12. parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut, nga prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave;

1.13. rritet ekspertiza specifike sektoriale në komunë dhe trajtimi i mbeturinave tu përmbahet standardeve profesionale dhe të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbeturina, këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;

1.14. përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave;

1.15. realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbeturinave me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis;

1.16. dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizike dhe juridik, ndotja dhe dëmtimi që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbeturinave.

**Neni 6**

**Reduktimi, Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave**

1. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Junikut, duhet të organizohet në atë mënyrë që mbeturinat të:

1.1. **Reduktohen** - prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave të parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut;

1.2. **Ripërdoren** - mbeturinat, kur ka mundësi, të ripërdoren apo përpunohen si lëndë e parë sekondare dhe si lëndë për përfitimin e energjisë;

1.3. **Riciklohen** - mbeturinat, kur është e mundur të riciklohen me qëllim që të përdorën si lëndë e parë sekondare;

1.4. **Riparim**- mbeturinat, kur është e mundur të riparohen me qëllim që të përdorën përsëri;

1.5. **Ripunim** - mbeturinat, kur ka mundësi, të ripunohen me qëllim që të përdorën përsëri.

**Neni 7**

**Trajtimi i barabartë**

Komuna, autoritetet komunale dhe operatori duhet të trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë konsumatorët, prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave në territorin e Komunës së Junikut dhe nuk mund të diskriminojë asnjë person në cilëndo prej bazave të përcaktuara në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi.

## KAPITULLI III - PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

**Neni 8**

**Dokumentet për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave**

1. Dokumentet për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave, siç përcaktohet në Ligjin për mbeturina, janë:

1.1. Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave (Strategjia), e cila propozohet nga ministria dhe miratohet nga Qeveria, për periudhën kohore dhjetë (10) vjeçare, dhe rishqyrtohet së paku në pesë (5) vjet;

1.2. Plani i Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave, i cili nxirret nga ministria për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh dhe i cili rishqyrtohet sipas nevojë;

1.3. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM), i cili nxirret nga komuna në pajtim me nenin 9 të kësaj rregulloreje;
1.4. Plani për menaxhimin e mbeturinave i cili nxirret nga zotëruesi i mbeturinave për periudhën pesë (5) vjeçare;
1.5. Plani për menaxhimin e mbeturinave nga operatori për menaxhimin e mbeturinave, i cili nxirret nga operatorët për periudhën pesë (5) vjeçare.

**Neni 9**
**Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave**

1. PKMM miratohet nga Kuvendi, dhe duhet të:
   1.1. jetë i harmonizuar me Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave;
   1.2. nxirret për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh dhe i cili rishqyrtohet sipas nevojës;
   1.3. hartohet në bashkëpunim me operatorët dhe në një proces publik dhe gjithëpërfshirës me pjesëmarrje të qytetarëve, institucioneve dhe organizatave të ndryshme joqeveritare.

2. Përmbajtja e PKMM, duhet të jetë në pajtim me paragrafin 6 të Nenit 10 të Ligjit për mbeturina.
3. Sipas nevojës dhe në marrëveshje, Komuna e Junikut së bashku me një a më shumë komuna mund të nxjerrin planin e përbashkët lokal për menaxhimin e mbeturinave.
4. Përgjegjës për zbatimin e PKMM janë organet komunale të përcaktuara në këtë rregullore dhe në PKMM.

**Neni 10**
**PKMM dhe masat për parandalim**

1. Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe programet, në të cilat përcaktohen masat për parandalimin e krijimit të mbeturinave, për të ndikuar që gradualisht të ndryshohen shprehitë e konsumatorëve për prodhim të mbeturinave.
2. Masat, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshijnë por nuk kufizohen në veprimet si në vijim:
   2.1. rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të krijimit të mbeturinave;
   2.2. përgatitja e ambientit për futjen graduale të tarifave volumetrike për të dekurajuar prodhimin e mbeturinave;
   2.3. promovimi dhe fasilitimi i skemës së kompostimit individual;
   2.4. promovimi përmes politikave të favorshme të hapjes së stacioneve rimbushëse dhe dyqaneve "zero mbeturina";

2.5. përgatitja e ambientit, dhe në koordinim me Qeverinë, për largimi nga tregu i artikujve një përdorimesh të tillë si qeset plastike dhe paketimeve një përdorimesh;
2.6. promovimi dhe facilitimi i restoranteve dhe objekteve gastronomike "zero mbeturina" për të reduktuar mbeturinat;
2.7. futja e stimujve të përshtatshëm fiskal, tarifave preferenciale, kontraktimi dhe prokurimi publik preferencial nga këto subjektet me "zero mbeturina".

3. Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe programet, në të cilat përcaktohen masat për reduktimin, ripërdorimin, riciklimin, riparimin dhe ripunimin e mbeturinave komunale por edhe kategorive tjera të mbeturinave, me theks të veçantë në mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi, mbeturinat e vëllimshme, mbeturinat e veçanta.

4. Masat, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshijnë por nuk kufizohen në veprimet si në vijim:
4.1. aktivitet vetëdijësuese për reduktimin, ripërdorimin, riciklimin, riparimin dhe ripunimin të mbeturinave;
4.2. përgatitjet për sigurimin e infrastrukturës për ndarjen e mbeturinave në burim dhe për hapjen e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit, ripërdorimit, riciklimit, riparimit dhe ripunimit të produkteve të hedhura;
4.3. analizat e kompozicionit të mbeturinave dhe potencialit të mbeturinave që mund të ricklohen, ripërdorën, riparohen dhe ripërpunohen dhe shikimi i mundësisë për hapjen e qendrës lokale/rajonale të kompostimit dhe për hapjen e qendrës për ripërdorimin dhe ripërpunimin e mbeturinave nga ndërtim dhe rrënimi;
4.4. përgatitja e ambientit për zbatimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe zotëruesit të mbeturinave.

### Neni 11
### PKMM dhe fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe përcaktohen masat për menaxhimin e mbeturinave gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme siç përcaktohet në Kushtetutë, si dhe për masat për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (Gazeta Zyrtare, nr. 22, 19 tetor 2011).

## KAPITULLI IV - DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

### Neni 12
### Zyrtari për Menaxhimin e Mbeturinave (ZMM)

1. Zyrtari për Menaxhimin e Mbeturinave, vepron në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim.

2. ZMM bashkëpunon me ministrin dhe me palët e interesuara për hartimin e dokumenteve për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave si dhe zbaton politikat në fushën e mbrojtjes, të përcaktuara nga ministritë përkatëse dhe legjislacioni përkatës në fuqi, për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale në Komunën e Junikut.
3. ZMM bashkëpunon me policinë, prokurorinë, gjykatat, dhe institucionet tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Neni 13
### Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për menaxhimin e mbeturinave

1. ZMM, ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
   1.1. planifikon, rregullon, udhëheqë dhe të zbaton aktivitete për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të Komunës së Junikut;
   1.2. harton, siguron dhe raporton zbatimin e PKMM, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
   1.3. udhëzon dhe mbikëqyrë ofruesit e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale;
   1.4. planifikon buxhetin për funksionimin e duhur të menaxhimit të mbeturinave;
   1.5. propozon tarifën për menaxhimin e mbeturinave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare;
   1.6. propozon, me njësitë tjera komunale, mënyrën e faturimit të tarifës për mbeturina, dhe për organizimin dhe shpërndarjen e faturave;
   1.7. siguron kushtet e veprimit dhe operimit për operatorët publikë dhe privatë;
   1.8. organizon menaxhimin e mbeturinave nga sipërfaqet publike;
   1.9. mbikëqyrë mbledhjen, transportimin deri në deponi të mbeturinave komunale, komerciale, inerte, të vëllimshme, nga ndërtimet dhe rrënimet, ushqimore, si dhe llojeve tjera të mbeturinave të cilat janë në kompetencë të nivelit lokal;
   1.10. njofton publikun për menaxhimin e mbeturinave dhe promovon ngritjen e vetëdijesimit publik - pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në menaxhimin e mbeturinave, në bashkëpunim me njësitë përkatëse në komunë;
   1.11. promovon minimizimin e mbeturinave (ripërdorim, reduktim, riciklim, riparim dhe ripunim të mbeturinave (5R);
   1.12. identifikon pikat/deponitë ilegale të hedhjes së mbeturinave dhe siguron evitimin e tyre;
   1.13. në bashkëpunim me njësitë tjera komunale siguron kushte veprimi dhe operimi për operatorin;
   1.14. harton raportet për menaxhimin e mbeturinave, përfshi raporte vjetore për menaxhimin e mbeturinave raportet për shkallën e arkëtimit të tarifës për mbeturina.

sipas kërkesave që dërgohet në Ministri si dhe raporteve tjera të përcaktuar në Ligjin për mbeturina dhe këtë rregullore;

1.15. bënë monitorimin mjedisor të deponisë së mbeturinave;

1.16. në emër të komunës përgatit dhe dërgon informacionet dhe rekomandimet e kërkuara nga Ministria, lidhur me menaxhimin e mbeturinave.

2. ZMM, sipas nevojës dhe në bashkëpunim me dhe përmes operatorit të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave komunale, përcakton:

2.1. vendndodhjen e pikave të grumbullimit të mbeturinave;

2.2. mënyrën e hedhjes së mbeturinave;

2.3. lokacionin për vendosjen e kontejnerëve dhe mënyrën e mirëmbajtjes së tyre, kur është e nevojshme një gjë e tillë;

2.4. kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit, të mbeturinave;

2.5. orarin dhe dinamikën për mbledhjen e mbeturinave, dhe sipas nevoje autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë;

2.6. mënyrat për transportim të mbeturinave komunale;

3. ZMM, përkujdeset që të themelohet komisioni i ankesave në kuadër të administratës komunale, i cili do të shqyrton ankesat e konsumatorëve sa u përket shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, tarifave dhe mënyrës së arkëtimit të tyre.

**Neni 14**

**Të drejtat e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave**

1. Çdo prodhues apo zotërues i mbeturinave dhe çdo konsumator ka të drejtë:

1.1. qasjeje në shërbimet publike për hedhjen dhe grumbullimin e mbeturinave;

1.2. të informohet dhe të kërkojë informata për menaxhimin e mbeturinave

1.3. të marrë pjesë dhe të kontribuojë në politikat për menaxhimin e mbeturinave;

1.4. të bëjë ankesë, ndaj shërbimit të ofruar dhe trajtimit dhe të marrë përgjigje në ankesën e bërë.

**Neni 15**

**Detyrat dhe përgjegjësitë e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave**

1. Çdo prodhues apo zotërues i mbeturinave ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1.1. të hyjnë në shërbim për trajtimin e mbeturinave qoftë person fizik apo juridik;

1.2. të regjistrohet në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave dhe të përditësojnë të dhënat në rastet e ndryshimit të adresës;

1.3. të bashkëpunojnë me autoritetet publike për të siguruar një mjedis të pastër;

1.4. të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes ripërdorimit, reduktimit, riciklimit, riparimit dhe ripunimit të mbeturinave (5R));

1.5. t`i respektojë rregullat e përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi dhe PKMM;

1.6. të paguaj për shërbimin e ofruar në bazë të tarifës së miratuar nga Komuna;

1.7. t'i hedhin mbeturinat e tyre në vende dhe sipas sistemit të caktuara nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t`i ndajnë dhe t`i dorëzojnë në vendet ose qendra grumbulluese të përcaktuara për atë lloj, në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.8. ta njoftojnë ZMM kur prodhojnë mbeturina gjatë meremetimit apo rrënimit të objekteve dhe të largojnë këto mbeturina, nga hapësirat ose vendet publike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave të veçanta, mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave medicinale, janë të detyruar të respektojnë legjislacionin në fuqi për trajtimin e këtyre mbeturinave dhe të përdorin sistemin e ndarjes së kontejnerëve dhe t`i dorëzojnë ato mbeturina në vendet e caktuara për to.

3. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave, për objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave, për të cilat sipas Ligjit për mbeturina, është e nevojshme të merret cilado nga lejet mjedisore, janë të detyruar të nxjerrin Planin për menaxhimin e mbeturinave, në pajtim me Neni 11 të Ligjit për mbeturina.

## KAPITULLI V - AKTIVITETET PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

### Neni 16
### Grumbullimi i mbeturinave

1. Grumbullimi i mbeturinave bëhet vetëm në vendet dhe mënyrat e mbledhjes së mbeturinave të cilat caktohen nga Komuna.

2. Ndryshimi i vendndodhjes së vendeve të mbledhjes së mbeturinave dhe hedhja e mbeturinave në kundërshtim me mënyrën e përcaktuar nga komuna, përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

3. Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendoset numër i mjaftueshëm i shportave apo kontejnerëve për mbeturina. Llojin, mënyrën, vendin dhe numrin e shportave apo kontejnerëve dhe të mjeteve tjera në sipërfaqe publike, e cakton ZMM, në bashkëpunim me operatorin.

4. Kontejnerët, nëse paraqitet nevoja, duhet të kenë mbishkrime të dukshme që udhëzojnë për klasifikimin e mbeturinave.

5. Personat juridik dhe fizik që marrin shërbimet derë me derë, hedhin mbeturinat sipas mënyrës që caktohet nga ZMM.

6. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rregullt të parqeve, sheshe dhe në vende tjera, është e obliguar të vendosë dhe të mirëmbajë numër të mjaftueshëm të kontejnerëve apo shportave për mbeturina.
7. Çerdhet, kopshtet dhe shkollat, publike e private, duhet të përdorin sistemin e disa kontejnerëve, shportave apo sisteme të caktuara të grumbullimit për të edukuar fëmijët dhe nxënësit me normat e rregullat bashkëkohore të trajtimit të ndarë të mbeturinave.

## Neni 17
## Hedhja dhe mbledhja e mbeturinave

1. ZMM përkujdeset që të bëhen publik orari i hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave, qoftë për shërbimet derë me derë apo për banesat kolektive.
2. Në procesin e vendimmarrjes për caktimin e orarit të hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave, ftohen të marrin pjesë operatorët, personat juridik dhe fizik, OJQ-të dhe publiku i interesuar.
3. Secili person ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurinë e procesit të hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave.
4. Sistemimi dhe hedhja e mbeturinave, nga prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave bëhet vetëm në mënyrën e caktuar dhe sipas orarit që ka caktuar komuna.
5. Kalimtarët, mbeturinat e çastit si ambalazhe të ndryshme, i hedhin vetëm në shportat apo kontejnerët e vendosur në hapësira publike ose që ndodhen para dyqaneve. Ndalohet hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.
6. Mbeturinat që dalin nga krasitja e pemëve, e hardhive, nga punimet në oborre, në lulishte e parqe, para se të dërgohen në vendet e mbledhjes së këtyre mbeturinave, priten në pjesë të vogla e palosen për të mos bllokuar kazanët dhe vështirësuar transportin.
7. Hedhja e mbeturinave jashtë këtij rregulli, përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
8. Hedhja e mbeturinave të rrezikshme, mbeturinave te veçanta, mbeturinave industriale, mbeturinave inerte, mbeturinave medicinale, mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe mbeturinave të tjera që nuk konsiderohen si mbeturina komunale sipas Ligjit dhe nga kjo rregullore, duhet të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga Komuna për këtë qëllim, dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
9. ZMM përkujdeset që komuna të sigurojë vendin në të cilin do të të bëhet hedhja e mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, dhe mbeturinave tjera të përcaktuar në paragrafin 8 të këtij neni.

## Neni 18
## Transportimi i mbeturinave

1. Transportimi i mbeturinave për në vendet e deponimit bëhet nga komuna ose operatori.

2. Transportuesit e mbeturinave bëjnë transportimin e mbeturinave në bazë të kushteve të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Bartja e mbeturinave bëhet gjatë ditës dhe gjatë natës, në orët e mbrëmjes apo herët në mëngjes, sipas orarit dhe dinamikës për mbledhjen e mbeturinave të caktuar nga ZMM, i cili bëhet publikë në ueb faqen e komunës.
4. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten, patjetër duhet të jenë të mbyllura ose të mbuluara, në mënyrë që të pengohet derdhja apo rishpërndarja e mbeturinave gjatë transportit deri në deponinë e caktuar.
5. Nëse ndotja ndodhë gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthejë në gjendje të mëparshme.
6. Nëse mbeturina e transportuara, nuk pranohet në deponinë e destinuar, transportuesi duhet ta kthej mbeturinën në vendin ku është marrë dhe të njoftojë ZMM.

**Neni 19**
**Deponitë e mbeturinave**

Deponimi i mbeturinave në Komunën e Junikut, në varshmëri të karakteristikave të mbeturinave, bëhet vetëm në deponitë e licencuara dhe të lejuara përkatëse në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për menaxhimin e deponive, si dhe sipas llojit përkatës të mbeturinave, që mund të jenë deponi për mbeturinat e rrezikshme, jo të rrezikshme dhe inerte.

## KAPITULLI VI - OPERATORËT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

**Neni 20**
**Operatorët për menaxhimin e mbeturinave**

1. Menaxhimi i mbeturinave bëhet përmes kontratave të veçanta me një apo më shumë operator publik ose privat për menaxhimin e mbeturinave, të cilët duhet të jenë të pajisur me leje përkatëse mjedisore për menaxhimin e mbeturinave dhe të cilët do të veprojnë sipas kushteve të përcaktuara me licencën për menaxhimin e mbeturinave të lëshuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Operatorët për menaxhimin e mbeturinave mund të jenë institucionet, kompanitë publike ose private të regjistruara sipas ligjit, të cilët shërbimet për komunën për menaxhimin e mbeturinave e kryejnë në bazë të kontratës.
3. Organi kontraktues i Komunës, duke u bazuar në dispozitat e ligjit përkatës të prokurimit, mund të përcaktojnë të gjitha kushtet nevojshme për përzgjedhjen e operatorit për menaxhimin e mbeturinave komunale, dhe mbeturinave: inerte, komerciale, të vëllimshme dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe rrënimet, brenda territorit të Komunës së Junikut.

4. Komuna mund të përzgjedhë për operator një ndërmarrje në pronësi të Komunës sipas legjislacionit në fuqi.

### Neni 21
### Menaxhimi i mbeturinave me partneritet publiko-privat

Menaxhimi i mbeturinave, ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e impianteve dhe objekteve për menaxhimi e mbeturinave mund të cpet në formën e partneritetit publiko-privat sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 22
### Kontrata me operatorin

1. Kontrata me operatorin duhet të specifikoj, së paku:
   1.1. territorin e saktë ku kryhen shërbimet;
   1.2. mënyrën e ofrimit të shërbimeve;
   1.3. specifikimin e pajisjeve për trajtim;
   1.4. mënyrën e raportimit në komunë;
   1.5. çështjet tjera që kërkohen sipas Ligjit, këtë rregullore dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veprojë sipas Ligjit, kontratës, kësaj rregulloreje dhe legjislacionit përkatës në fuqi dhe përmbush të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e operatorit të përcaktuar në Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

## KREU VII- KATEGORIZIMI I KONSUMATORËVE DHE TARIFAT PËR SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

### Neni 23
### Kategorizimi i konsumatorëve dhe caktimi i tarifave për menaxhimin e mbeturinave

1. Konsumatorët, gjegjësisht prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave, kategorizohen si në vijim:
   1.1. Konsumatorët e amvisërive;
   1.2. Konsumatorët komercialë dhe industrialë;
   1.3. Konsumatorët institucionalë.
2. Kuvendi cakton nënkategoritë e konsumatorëve dhe tarifat për menaxhimin e mbeturinave.

3. Gjatë caktimit të tarifave duhet marrë parasysh shërbimit për secilën kategori, dhe duke marrë parasysh ndikimin e tarifave në mjedisin jetësor dhe rekomandimin e ZMM dhe operatorëve.
4. ZMM në bashkëpunim me operatorin krijojnë, mirëmbajnë dhe përditësojnë listën e konsumatorëve, duke përfshirë edhe kategorizimin dhe nënkategorizimin e tyre.

**1.1 Kategoria e konsumatorëve shtepiak –amvisëritë:**

- Nënkategoria e parë: konsumatorët e sherbyer derë me derë - zona urbane dhe zona rurale
- Nënkategoria e dytë: konsumatorët e sherbyer me kontejnerë të përbashkët zona urbane dhe zona rurale.
- Nënkategoria e tretë: konsumatorët (banoret jo resident).

**1.2** Kategoria e konsumatorëve Komercial / Industrial:

- **Nënkategoria e Parë:** veprimtarit e vogla zejtare dhe shërbyese. Në këtë kategori bëjnë pjesë këto veprimtari të bizneseve: kioska, Kafe pjekëse shitore, shitës të CD-ve dhe kasetave, argjendari, orëtar, agjensione turistike, avokatura, servise te ndryshme(elektroteknike dhe TI), video lojrat, video club, internet kafe, rrobaqepës, këpucëtarë, dyqan fotografish, pastrim kimik, kozmetika, optika, gurë gdhendës, saraç-mbathtarë, zyra e inkasimit, zyre të partive politike, llamarin punues, axhustator, kurse të gjuhëve dhe IT-së

- **Nënkategoria e dytë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industrial me kosto të ulët të shërbimit. Në këtë kategori bëjnë pjesë këto veprimtari të bizneseve: auto larje, frizer meshkujsh dhe femrave, ëmbëltore, shitore tekstili, shitore të auto-pjesëve, hekurishte, salon i vogel i mobileve, shitore këpucësh, shitore të ndryshme, objekte fetare të vogla, farmaci, zyrat postare e te ngjashme, klinike(ordinana private), ordinance stomatologjike deri ne dy karrige, automekanik, autoelektricist, autosaldues, autosallon.

- **Nënkategoria e tretë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industriale me kosto te moderuar të shërbimit. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë këto veprimtari të bizneseve: furra të bukës dhe byrektore, gjelltore , qebaptore, kafiteri, minimarket-shitore ushqimore, podrume të pijeve, poliklinika, filial të bankave, sallone të sanitarisë, salon i madhë mobilesh, qendra sportive të ngjashme, qendra të fitnesit, auto ngjyroses, fastfood, bujtina, pompa të benzines, xhampreres dhe ordinance stomatologjike mbi 2 karrige.

- **Nënkategoria e katërt**: subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industrial me kosto të lartë të shërbimit. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë këto veprimtari të bizneseve, restorant-qebaptore, restorante, fastfood-restorant, diskoteka, hotele, motele dhe pompa të benzines me restorant.

- **Nënkategoria e pestë:** subjektet komerciale / industrial të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontenjera 1.1 m³ dhe 7m³. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë të gjithë subjektet komerciale / industrial të cilët kanë hapësirë që brenda pronës së tyre të vendosin kontenjerë 1.1 m³ dhe 7m³.

**1.3Kategoria e konsumatorëve institucional.**

- Konsumatorët në këtë kategori do të shërbehen me kontrata të veçanta me kontejnerë 1.1 m³ dhe 7 m³.

Kategoria e konsumatorëve institucional ndahet në:

1. Nënkategorinë e konsumatorëve të institucioneve komunale dhe
2. Të konsumatorëve të institucioneve të nivelit qendror dhe organizatave ndërkombëtare.

Në nënkategorinë e konsumatorëve të institucionev komunale bëjnë pjesë: shkollat fillore dhe të mesme, institucionet parashkollore, Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare, bashkësitë lokale, zyret e vendit, objektet e komunes, teatri, kinemaja, objektet kulturore, objektet sportive dhe zjarrëfiksat.

Në nënkategorinë e konsumatorëve të institucione qendrore dhe organizatave ndërkombëtare bëjnë pjesë : spitali rajonal, universitete, qendra e studenteve, Policia e Kosovës, ndërmarrjet publike, posta, institucionet qendrore të gjyqësisë ( gjykata, prokuritë, burgjet ) agjencionet e pavarura, organizatat ndërkombëtare, shkolla speciale, qendra e shendetit mentale, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe qendra për punë sociale.

TARIFA PËR GRUMBULLIM, TRANSPORTIM DHE DEPONIM TË MBETURINAVE

1- Kategoritë e konsumatorëve do të paguajnë faturë mujore për shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave si në vijim:

   a. **Kategoria e konsumatorëve shtëpiak – amvisëritë**: Nënkategoria e pare dhe Nënkategoria e dyte konsumatoret (banoret resident) do të paguajnë tarifë fikse 6.00 € (me TVSH) ne muaj.

Nënkategoria e tretë, konsumatoret (banoret jo resident) do të paguajnë tarifën fikse në vlerë prej 2.00 Euro (me TVSH) në muaj.

b. **Kategoria e konsumatorëve Komercial / Industrial.**

1. **Nënkategoria e pare:** veprimtarit e vogla zejtare dhe shërbyese do të paguajnë tarifë fikse prej 6.00 Euro (me TVSH) në muaj.

2. **Nënkategoria e dytë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industrial me kosto të ulët të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 11.00 Euro (me TVSH) në muaj.

3. **Nënkategoria e tretë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industrial me kosto të moderuar të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 17.20 Euro (me TVSH) në muaj.

4. **Nënkategoria e katërt:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industriale me kosto të lartë të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 26.00 Euro (me TVSH) në muaj. Në këtë kategori kemi edhe biznese ë mëdha me kontrata te veqanta fikse.

5. **Nënkategoria e pestë:** subjektet komerciale / industriale të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontejnerë 1.1 $m^3$ dhe $7m^3$ do të paguajnë tarifë prej 14.00 Euro (me TVSH), për një zbrazje për kontejnerë $1.1m^3$ dhe 45.00 Euro (me TVSH) për një zbrazje për kontejnerë $7m^3$

6. **Kategoria e konsumatorëve institucional:** Të sherbyer me kontrata të vecanta, konkretisht me kontinjerë 1.1 $m^3$ do të paguajnë tarifë prej 14.00 Euro (me TVSH) për një zbrazje dhe 45.00 Euro (meTVSH) për një zbrazje për kontejnerë $7m^3$.

### Neni 24
### Faturimi i mbeturinave

1. Faturimi i mbeturinave bëhet në baza mujore.
2. Konsumatorët janë të obliguar të paguajnë tarifat për menaxhimin e mbeturinave dhe sipas shumës së përcaktuar nga Komuna.

## KREU VIII - INFORMIMI, PROMOVIMI DHE RAPORTI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

### Neni 25

**Seanca/t vjetore për çështjet e menaxhimit të mbeturinave**

1. Kuvendi organizon të paktën një (1) seancë vjetore, apo se paku në një seancë e diskuton në rend të ditës çështjet e menaxhimit të mbeturinave.
2. Në seancën/at vjetore ku diskutohet për menaxhimin e mbeturinave, secili drejtor i drejtorisë komunale raporton për çështjet, veprimet dhe masat që janë në përgjegjësinë e tij dhe që kanë të bëjnë dhe që ndërlidhen më menaxhimin e mbeturinave, si dhe paraqesin aktivitetet që janë ndërmarrë për realizimin e PKMM.
3. Në seancën/at vjetore për menaxhimin e mbeturinave, ku diskutohet për menaxhimin e mbeturinave, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile.
4. Seanca/at vjetore për menaxhimin e mbeturinave organizohen në koordinim me Drejtorine per Sherbime Publike dhe Inspeksion.

**Neni 26**
**Ditët e Komunës së pastër**

1. Nën patronatin e Kryetarit organizohen dhe mbahen "Ditët e Komunës së pastër".
2. Gjatë këtyre ditëve organizohen aktivitete të ndryshme me pjesëmarrjen e subjekteve të ndryshme që merren me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në territorin e Komunës.
3. Kryetari, me vendim, cakton datat për "Ditët e Komunës së pastër", dhe përcakton përgjegjësitë e mekanizmave përkatëse për detyrat e tyre në këto ditë dhe aktivitetet konkrete që duhet ndërmarrë.
4. Në ditët e Komunës së pastër, Kryetari mund të vendos që të bëhet pa pagesë grumbullimi, transportimi dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme.

**Neni 27**
**Informimi, promovimi dhe ngritja e vetëdijes për menaxhimin e mbeturinave**

1. Komuna e Junikut është transparente ndaj palëve të interesuara për dhënien e informatave për menaxhimin e mbeturinave.
2. Organi i informimit i Komunës së Junikut, në bashkëveprim me Drejtorinë për Sherbime Publike dhe Inspeksion:
   2.1. përmes fushatave, ligjëratave publike si dhe materialeve të ndryshme promovuese për ngritjen e vetëdijes për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në territorin e Komunës së Junikut, krijojnë një sistem të informimit për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut dhe informata të tjera të cilat janë në interes të qytetarëve;
   2.2. promovojnë konceptin e 5R (reduktim, ripërdorim, riciklim, riparim dhe ripunim të mbeturinave) për të synuar që gradualisht në Komunën e Junikut të fillojë ndarja e

mbeturinave (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të ngritë vetëdijen e qytetarëve dhe bizneseve rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

3. Për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, Organi i informimit në Komunën e Junikut, në bashkëveprim me ZMM, mund të bashkëpunojnë me konsumatorët dhe me shoqërinë civile.

**Neni 28**
**Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave**

1. ZMM monitoron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe harton raporte vjetore për menaxhimin e mbeturinave.

2. Obligohen të gjitha njësitë përkatëse të komunës për bashkëpunimin dhe ofrimin e të dhënave të kërkuara nga ZMM.

3. Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave duhet dorëzuar në Ministri, deri më 31 mars të vitit vijues, siç është përcaktuar në Nenin 58 të Ligjit për mbeturina.

4. Operatorët që merren me menaxhimin e mbeturinave paraqesin Raportin vjetor deri më 31 mars të vitit vijues. Raporti paraqitet në Komunë dhe në Ministri.

5. Raporti nga paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni, duhet të përmbajnë të dhënat për:

   5.1. llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin, trajtimin, përpunimin, riciklimin, magazinimin dhe deponimin e mbeturinave si dhe mbeturinave të cilat pranohen në objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave;

   5.2. llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin dhe destinimin e lëndës së parë sekondare të përfituar në objektet për menaxhimin e mbeturinave;

   5.3. çështje tjera të rëndësishme.

6. Raporti nga paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni plotësohet sipas Shtojcës VI. të Ligjit, dhe në pajtim me aktin nënligjor i cili rregullon kushtet dhe kriteret për raportimin për menaxhimin e mbeturinave.

## KAPITULLI IX - BASHKËPUNIMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

**Neni 29**
**Bashkëpunimi për menaxhimin e mbeturinave**

Të gjitha njësitë përbërëse të komunës dhe administrata komunale, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të tyre, janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për identifikimin e çështjeve të zbatimit të masave dhe gjetjes së mënyrave me efektive për menaxhimin e mbeturinave si dhe për zbatimin e Ligjit, kësaj rregulloreje, legjislacionit në fuqi dhe PKMM-së.

**Neni 30**
**Bashkëpunimi ndër-komunal**

Për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të menaxhimit të mbeturinave, Komuna e Junikut, kur është interesin publik të tyre, mund të bëjnë marrëveshje për menaxhimin e mbeturinave me një apo më shumë komuna të Republikës së Kosovës në pajtim me format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal, dispozitat e të cilit ligj vlejnë edhe për të gjitha format e bashkëpunimit ndër-komunal për menaxhimin e mbeturinave.

**Neni 31**
**Bashkëpunimi me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile**

1. ZMM, operatorët, organet dhe administrata komunale, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të tyre:
   1.1. bashkëpunojnë me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile për realizimin e politikave të menaxhimit të mbeturinave, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
   1.2. sigurojnë, inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e konsumatorëve dhe organizatave të shoqërisë civile në çështjet e menaxhimit të mbeturinave dhe në aktivitetet planifikuese dhe zbatuese si dhe u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla;
   1.3. mbajnë komunikime të rregullta me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e menaxhimit të mbeturinave në komunë nga një perspektivë tjetër.

## KREU X - MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE KUNDËRVAJTJET

**Neni 32**
**Mbikëqyrja inspektive**

1. Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal për mbrojtjen e mjedisit, në kuadër të

përgjegjësive sipas dispozitave të nenit 62 deri në nenin 69 të Ligjit dhe dispozitave tjera të legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Inspektori komunal për mbrojtjen e mjedisit, mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës, duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

3. Inspektori komunal për mbrojtjen e mjedisit, në kuadër të përgjegjësive është i autorizuar të marrë masa preventive për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut si dhe të shqiptojë gjobë për kundërvajtjet e përcaktuar me Ligjin për mbeturina dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Në rastet kur mungon inspektori komunal për mbrojtjen e mjedisit, punët, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, i kryen zyrtari komunal sipas paragrafit 3 të këtij neni, i cili kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit komunal për mjedis.

5. Inspektori komunal për mjedis, sipas marrëveshjes nga neni 15 paragrafi 2, neni 65 dhe neni 67 të Ligjit, mund të mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave edhe në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjinden jashtë territorit të komunës së Junikut dhe njëkohësisht komuna mund të lidhë marrëveshje që inspektori mjedisor komunal i komunës tjetër të kryejë inspektimin në territorin e Komunës së Junikut.

**Neni 33**
**Kundërvajtjet dhe veprat penale**

1. Në territorin e Komunës së Junikut, kur nuk përbëjnë vepër penale, do të dënohen për kundërvajtje dhe gjobiten me gjoba të përcaktuara, personat fizik, personat juridik dhe personat përgjegjës të personave juridik, për mosrespektim të dispozitave të:
   1.1. Neneve 71, 73 dhe 74 të Ligjit për mbeturina, dhe
   1.2. Neneve 137, 138 dhe 139 të Ligjit Nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit (Gazeta Zyrtare, nr. 11, 14 qershor 2018).
   1.3. Neneve të ligjeve përkatëse në fuqi.

2. Kur shkeljet e dispozitave të Ligjit për mbeturina dhe legjislacionit përkatës në fuqi përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal, inspektori komunal përmes kryetarit të komunës bënë kallëzimin penal.

**Neni 34**
**Procedurat e ankesës**

Kundër vendimit të inspektorit mund të parashtrohet ankesa në pajtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare, nr. 20, 21 qershor 2016).

**Neni 35**

**Mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur**

1. Për tëre mbeturinat e hedhura në hapësira publike ose jashtë deponive të mbeturinave, përgjigjet hedhësi i tyre.

2. Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave, ne pajtim me përgjegjësitë ligjore, nuk përkujdeset për mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur dhe nuk mund të identifikohet hedhësi, përgjegjësinë për ato mbeturina e bartë Komuna, e cila siguron largimin e tyre.

## KAPITULLI XI - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

**Neni 36**
**Përgjegjësia individuale**

Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të legjislacionit përkatës për çështjet e menaxhimit të mbeturinave, kur me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë kundërvajtje dhe shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi.

**Neni 37**
**Procedura përmbarimore dhe gjyqësore**

Ndaj konsumatorëve të cilët nuk bëjnë pagesën e tarifës për mbeturina do të iniciohet procedurë procedura përmbarimore dhe gjyqësore nga njësitë përkatëse të komunës apo nga operatori i kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave komunale, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Neni 38**
**Buxhetimi**

1. Financimi i menaxhimit të mbeturinave sigurohet nga pagesat e konsumatorëve, buxheti komunal, Buxheti i Republikës së Kosovës, donacionet dhe burimet tjera financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe me legjislacionin përkatës që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave, organet dhe administrata përkatëse komunale, gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal planifikojnë buxhet për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave si dhe sigurojnë burime njerëzore, financiare dhe logjistike të nevojshme.

3. Komuna e planifikon buxhetin komunal, i cili është transparent dhe bazohet ne konsultime me palët.

4. Administrata dhe organet komunale zhvillojnë një proces për analizimin e nevojave te buxhetimit për menaxhimin e mbeturinave, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit.
5. Kryetari bashkëpunon me Ministrinë dhe me donator të ndryshëm për prioritetet për marrjen e fondeve për menaxhimin e mbeturinave.

## Neni 39
## Regjistri i deponive ilegale

ZMM në afat prej gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të përgatisë regjistrin e deponive ilegale në territorin e Komunës së Junikut, sipas dispozitave të Ligjit për mbeturina.

## Neni 40
## Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave

Për të siguruar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, të gjithë punonjësit e komunës, veçanërisht punonjësit që kanë përgjegjësi direkte në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, janë të obliguar të ndjekin trajnime dhe aktivitete që synojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre në këtë fushë si dhe të venë në shfrytëzim, në punën e tyre të përditshme, njohurinë dhe dijen e përftuar.

## Neni 41
## Zbatimi

1. Zbatimit të kësaj rregulloreje në territorin e Komunës së Junikut i nënshtrohen:
   1.1. ZMM si dhe organet dhe administrata komunale;
   1.2. operatorët e angazhuar për menaxhimin e mbeturinave;
   1.3. të gjithë personat fizik dhe juridik, kalimtarët e rastit dhe turistët dhe që ushtrojnë veprimtari dhe që ndodhen në territorin e Komunës;
   1.4. subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike;
2. Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Kryetari, me mbështetjen e drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe ZMM.
3. Administrata dhe organet komunale janë të obliguara qe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive përkatëse.
4. Për të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave.
5. Kryetari mund të nxjerrë Vendime për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

**Neni 42**
**Interpretimi i Rregullores**

1. Kjo rregullore duhet interpretuar dhe zbatuar brenda kuadrit të Kushtetutë, Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Ligjit për mbeturina, dhe Statutit të Komunës.
2. Në të gjitha rastet kur ka kundërthënie të kësaj Rregulloreje me Ligjet dhe dispozitat e Statutit të Komunës do të zbatohen dispozitat e ligjeve dhe statutit.

**Neni 43**
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja e datës 28.06.2013 për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Junikut.

**Neni 44**
**Publikimi**

1. Kjo rregullore publikohet në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtare.
2. Kjo rregullore dhe ndryshimet e mëpasshme të saj publikohen ueb faqen e komunës dhe në "Gazetën Zyrtare".

**Neni 45**
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Rregullore pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, publikohet në ueb faqen e komunës.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës.
3. Në ditën në të cilën kjo rregullore publikohet në ueb faqe të komunës do të përcaktohet si dita e shpalljes.

**Shpejtim Gacaferi,**

______________

**Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut**

**Datë:** ___.__________.20___